



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 577 Akti

V E N D I M
(i ndërmjetëm)
Nr. 6, datë 13.5.2022

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj	Kryesues
Valbona Sanxhaktari	Relatore
Genta Tafa (Bungo)	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Elda Faruku, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot, në datën 10.5.2022, në orën 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim çështjen e subjektit të rivlerësimit Marsida Frashëri, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, dhe

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5, të nenit 179/b, të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1, të nenit 5, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Znj. Marsida Frashëri, aktualisht, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, është subjekt i rivlerësimit, që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 15.6.2020, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit Marsida Frashëri, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Lulzim Hamitaj dhe Valbona Sanxhaktari. Si relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Valbona Sanxhaktari.
4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 18.6.2020 u caktua me mirëkuptim kryesues komisioner Lulzim Hamitaj, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin Marsida Frashëri.
5. Në referim të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit Marsida Frashëri nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.
6. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e

hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

7. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 4.4.2022, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret për subjektin e rivlerësimit Marsida Frashëri, si dhe njoftimin e subjektit për t'u njohur me materialet e dosjes dhe rezultatet e hetimit në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

8. Subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi të drejtën e saj për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni me anë të postës elektronike të datës 4.4.2022.

9. Subjekti i rivlerësimit kërkoi kohë shtesë për dorëzimin e materialeve shpjeguese, përkatësisht në datat 14.4.2022 dhe 21.4.2022 dhe të dyja këto kërkesa janë pranuar nga Komisioni. Në datën 3.5.2022, subjekti i rivlerësimit dërgoi nëpërmjet postës elektronike parashtrime në lidhje me rezultatet e hetimit, si dhe paraqiti prova dhe dokumentacion mbështetës.

10. Pas administrimit të parashtrimeve të subjektit, provave dhe dokumentacionit, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

11. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në datën 10.5.2022, në orën 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot.

12. Subjekti i rivlerësimit Marsida Frashëri mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

13. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

14. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI;
- ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e subjektit, dërguar në Komision;

- d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja;
- ë) denoncimet e publikut;
- f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ; si dhe
- g) shpjegimet e subjektit gjatë seancës dëgjimore.

15. Në këtë vendim do të trajtohet vetëm vlerësimi në lidhje me kriterin e aftësive profesionale të subjektit Marsida Frashëri, bazuar në nenin E, si dhe në pikën 2, të nenit E, të Aneksit Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

16. Në lidhje me dy kriteret e tjera Komisioni do të shprehet në vendimin përfundimtar, pasi subjekti të ketë përfunduar programin e edukimit njëvjeçar pranë Shkollës së Magjistraturës dhe të jetë testuar për aftësitë e saj.

IV. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

17. Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në (a) raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLP-ja; (b) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; (c) denoncimet e paraqitura në Komision; (ç) dokumentacionin e mbledhur nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

A. Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të analizuar nga KLP-ja

Gjatë periudhës së vlerësimit, subjekti i rivlerësimit, prokurorja Marsida Frashëri ka përzgjedhur dhe ka paraqitur tri dokumente ligjore të llojit “vendim për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës”, “kërkesë për vleftësimin e arrestit në flagrancë, caktimin e masës së sigurimit dhe gjykimin e drejtpërdrejtë të çështjes penale”, si dhe “vendim për kryerjen e ekspertimit psikiatriko - ligjor”, të cilët janë analizuar nga KLP-ja. Nga analizimi i tyre ka rezultuar si në vijim.

1. Dokumenti ligjor “Vendim për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës”, në lidhje me procedimin penal nr. ***, me të pandehur shtetasin M. K..

Nga shqyrtimi i akteve ka rezultuar se në datën 6.8.2015, shtetasja V. K. ka kallëzuar penalisht bashkëshortin e saj M. K. për ushtrim të dhunës fizike ndaj saj.

Bazuar në nenin 34/1 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti i rivlerësimit, me vendimin datë 8.10.2015 ka vendosur të marrë si të pandehur shtetasin M. K. për kryerje të veprës penale “dhuna në familje”, parashikuar nga neni 130/a, paragrafi i parë, i Kodit Penal.

Dokumenti ligjor “Vendim për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës” është i strukturuar në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese – arsyetuese dhe pjesën konkluduese.

Subjekti ka bërë analiza ligjore mbi provat e administruara duke trajtuar edhe elementët e figurës së veprës penale të konsumuar, të parashikuar nga neni 130/a, paragrafi i parë, i Kodit Penal.

Nga shqyrtimi i aktit ligjor konstatohet se janë respektuar rregullat e drejtshkrimit, fjalitë paraqiten të qarta dhe përmbajnë referenca ligjore. Dokumenti paraqitet i strukturuar në paragrafë të ndarë nga njëri-tjetri, duke përmendur në arsyetim normat e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale.

Subjekti ka vlerësuar të japë shpjegime lidhur me këtë çështje, sa vijon: *Në listimin e provave janë përfshirë shprehimisht të gjithë provat mbi bazën e të cilave u konkludua për akuzën në ngarkim të personit. Kuptimi i provës dhe llojet e provave parashikohen në dispozitat e Titullit*

IV të Kodit të Procedurës Penale sipas të cilave provat tipike janë: dëshmia, thëniet e të pandehurit me këtë cilësi dhe palëve private, ballafaqimi, njohja, eksperimenti, ekspertimi, prova materiale dhe dokumentet. Në faktin-objekt hetimi, i pandehuri, në prani të mbrojtësit të tij, është njohur me provat dhe nuk ka ngritur ndonjë pretendim duke u shprehur se nuk kishte pretendime për akuzën.

Shpjegimet e subjektit duken të mjaftueshme për Komisionit.

2. Dokumenti ligjor “Kërkesë për vleftësimin e arrestit në flagrancë, caktimin e masës së sigurimit dhe gjykimin e drejtpërdrejtë të çështjes penale”.

Shërbimet e policisë rrugore në datën 2.11.2015 kanë ndaluar për kontroll shtetasin V. T. në drejtimin e automjetit tip “Citroen”, i cili ka rezultuar se kishte konsumuar sasi alkooli dhe është arrestuar në flagrancë, i dyshuar për kryerjen e veprës penale “drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, në gjendje të dehur¹, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal.

Dokumenti ligjor “Kërkesë për vleftësimin e arrestit në flagrancë, caktimin e masës së sigurimit dhe gjykimin e drejtpërdrejtë të çështjes penale”, është i strukturuar në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese - arsyetuese dhe pjesën konkluduese.

Subjekti ka administruar në fashikullin e hetimit, aktet paraprake të policisë gjyqësore, raportin e shërbimit, procesverbalin e verifikimit të alkooltestit me aparatën *Drager 7510*, procesverbalin për sekuestrimin e mjetit, si dhe procesverbalin e shpjegimeve të dhëna nga personi nën hetim.

Në analizë të tërësisë së akteve të administruara, subjekti ka arritur në konkluzionin që mund të aplikohet procedura e gjykimit të drejtpërdrejtë, sipas përcaktimeve të nenit 400 të Kodit të Procedurës Penale pasi çështja mund të zgjidhet në atë fazë që ndodheshin aktet.

Subjekti ka vlerësuar se plotësoheshin kushtet dhe kriteret për gjendjen e arrestimit në flagrancë sipas kërkesave të parashikuara në nenet 251 dhe 252 të Kodit të Procedurës Penale, duke vlerësuar që ekzistonte gjendja e flagrancës në kryerje e sipër të veprës penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal.

Subjekti ka trajtuar ekzistencën e kushteve të parashikuara në nenet 228 dhe 238 të Kodit të Procedurës Penale për caktimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg”, ndaj shtetasit të arrestuar, si dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova për kryerjen e një krimi, kushtet ligjore për marrjen në përgjegjësi penale, rrezikshmërinë e kryerjes së krimeve të të njëjtit lloj ose më të rëndë, mundësinë e largimit për shmangien nga përgjegjësia penale.

Nga shqyrtimi i aktit ligjor konstatohet se janë respektuar rregullat e drejtshkrimit, dokumenti paraqitet i strukturuar në paragrafë të ndarë nga njëri-tjetri, përshkruhet fakti i ndodhur, veprimet hetimore të kryera dhe analiza ligjore mbi provat e administruara, mbi bazën e të cilave argumentohet plotësimi i kriterëve ligjore për arrestimin në flagrancë, plotësimi i kriterëve ligjore për caktimin e një mase sigurimi duke vlerësuar që masa më e përshtatshme është ajo arrestit në burg, si dhe plotësimi i kriterëve ligjore për të vazhduar gjykimin e të pandehurit sipas përcaktimeve të nenit 400 e vijues të Kodit të Procedurës Penale.

3. Dokumenti ligjor “Vendim për kryerjen e ekspertimit psikiatriko - ligjor”, në lidhje me procedimin penal nr. ***, për veprën penale “dhuna në familje”, parashikuar nga neni 130/a, paragrafi i parë, i Kodit Penal, mbi bazën e akteve të referuara nga policia gjyqësore e Komisarariatit të Policisë Shkodër.

Në datën 24.1.2016, shtetasi P. Gj. ka ushtruar dhunë fizike ndaj bashkëshortes së tij A. Gj. dhe në bazë të konkluzioneve të ekspertëve mjeko-ligjorë, dëmtimet e shkaktuara klasifikoheshin në humbje të aftësisë së përkohshme në punë në masën deri në nëntë ditë.

¹Nocioni gjendje e dehur i referohet nenit 184, pika 6, e Kodit Rrugor, i ndryshuar, në të cilin është përcaktuar se në nivelin alkoolik mbi 0.5 g/l, drejtuesi konsiderohet në gjendje të dehur, duke përcaktuar edhe procedurën që ndiqet dhe sanksionet përkatëse.

Dokumenti ligjor “Vendim për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës”, është i strukturuar në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese - arsyetuese dhe pjesën konkluduese.

Subjekti, pasi ka përshkruar rrethanat e rezultuara nga hetimet e kryera, ka arsyetuar nevojën e kryerjes së ekzaminimit mendor të personit nën hetim për të përcaktuar nëse vuante nga ndonjë sëmundje, e cila ishte gjendja mendore e tij, si dhe shkallën e përgjegjshmërisë në lidhje me veprimet e kryera, konkluzion i domosdoshëm për të vlerësuar më pas përgjegjësinë penale për veprën e kryer.

Subjekti, fillimisht, ka përshkruar faktin e ndodhur dhe veprimet hetimore të kryera në kuadër të procedimit penal, ka administruar informacion shkresor nga Shërbimi i Psikiatrisë Shkodër, i cili konfirmonte faktin që shtetasi P. Gj. kishte qenë i shtruar në spital me diagnozën epilepsi me kriza të shpeshta, prapamendje mendore, si dhe kishte qëndruar në spital nga data 17.2.2006 deri në datën 20.2.2006. Subjekti ka vlerësuar që paraqitej e nevojshme kryerja e një ekspertimi psikiatriko-ligjor për të verifikuar shkallën e përgjegjshmërisë së personit nën hetim për veprimet e kryera prej tij.

Në fund është bërë analiza ligjore mbi provat e administruara, mbi bazën e të cilave është arritur konkluzioni se shtetasi M. K. kishte konsumuar plotësisht elementët e figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 130/a, paragrafi i parë, i Kodit Penal dhe duhej të akuzohej për kryerje të kësaj vepre penale.

Në përfundim konstatohet se subjekti ka depozituar një dokument, i cili nuk mund t'i nënshtrohet procedurës së rivlerësimit, sepse është një vendim prej të cilit nuk mund të dallohen aftësitë e saj profesionale pasi ai lidhet me një veprim hetimor pa afat në kuadër të një hetimi dhe nuk plotëson kriteret e parashikuara nga neni 3/2 i ligjit nr. 84/2016.

Subjekti i rivlerësimit, në vijim të rezultateve, shpjegon se në përzgjedhjen e këtij vendimi ka pasur në vëmendje disa faktorë që në tërësinë e tyre japin të dhëna për aftësitë profesionale: *“Më lejoni të shpreh mendimin se afatet procedurale disjelojnë procesin por nuk tregojnë domosdoshmërisht cilësinë e punës së prokurorit dhe thelbin e ushtrimit të ndjekjes penale. Veprimtaria e magjistratit duhet të vlerësohet nga aktet procedurale që ai ndërmer në ushtrimin e funksioneve të tij. Vendimi për caktimin e ekspertit dhe përcaktimi i detyrave ekspertit përbën një akt procedural edhe gjatë fazës së hetimeve paraprake. Aktet procedurale nuk janë dokumente pasi këto të fundit përbëjnë një burim tjetër prove sipas Kodit të Procedurës Penale dhe nuk krijohet nga vullneti i organeve procedurale penale, por i organeve të administratës publike jashtë procedurës hetimore apo gjyqësore. Komisioni duhet të mbajë në konsideratë këto veçori të aktit procedural (vendimi për caktimin e ekspertit) dhe dokumentit si burim prove krijuar jashtë procesit penal”*.

Shpjegimet e subjektit dalin jashtë kontekstit të procesit të rivlerësimit dhe kriterëve të përcaktuara për vlerësimin profesional, sipas parashikimeve ligjore.

B. Gjetjet nga vëzhgimi/shqyrtimi i pesë dosjeve të përzgjedhura me short

Dosja nr. 1 – Kallëzimi penal nr. *** (vendosur mosfillimi i procedimit/akti – vendimi i mosfillimit)

Në datën 31.8.2015 është paraqitur para oficerëve të policisë gjyqësore në Komisariatin e Policisë së Malësisë së Madhe, shtetasi A. K., i cili ka kallëzuar largimin nga banesa të vajzës së tij 18-vjeçare, L. K., duke argumentuar se mund të ishte trafikuar prej shtetasit F. H. Familjarët e kallëzuesit kanë bërë të mundur gjetjen e vendndodhjes së shtetasës J. K. në datën 18.9.2015.

Në datën 4.5.2015 subjekti ka nxjerrë urdhrin për kryerjen e veprimeve verifikuese.

Veprimet e para hetimore janë kryer përpara oficerit të policisë gjyqësore, ku shtetasja J. K. ka shpjeguar se ishte larguar me dëshirën e saj nga banesa. Ajo kishte qëndruar në vende të ndryshme me persona të ndryshëm, por asnjë prej tyre nuk e kishte keqtrajtuar, dhunuar apo

abuzuar me të. Në lidhje me familjarët e saj, shtetasja J. K. ka shpjeguar se nuk kishte asnjë pretendim ndaj tyre pasi largimi nga banesa ishte zgjedhje personale e saj. Në lidhje me shtetasit F. H., J. B., A. K. dhe V. P. ka shpjeguar se i ka njohur vetëm në rrjetin social, por nuk i ka takuar asnjëherë.

Në analizë të të dhënave të administruara, subjekti ka konkluduar që nuk konstatoheshin elementë të ndonjë vepre penale dhe bazuar në nenet 290/1, germa “ç” dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale ka vendosur mosfillimin e procedimit penal në datën 22.9.2015.

Dokumenti ligjor “Vendim mosfillimi” është i strukturuar në tri pjesë: pjesa hyrëse; pjesa përshkruese-arsyetuese; si dhe dispozitivi.

Fillimisht pasqyrohet fakti i përshkruar në materialin kallëzues, më tej përshkruhen të dhënat që rezultojnë nga verifikimet e kryera.

Nga përmbajtja e dokumentit të mësipërm konstatohet se janë respektuar rregullat e drejtshkrimit, fjalitë paraqiten të qarta dhe teksti i kuptueshëm. Dokumenti paraqitet i strukturuar në mënyrë të rregullt, paragrafët janë të ndarë nga njëri-tjetri dhe në arsyetimin e vendimit referohen normat e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale ku mbështetet vendimi.

Rezulton se vendimi i mosfillimit të procedimit penal është marrë brenda afateve të parashikuara në legjislacionin procedural penal, i është njoftuar palës më datë 1.10.2015 dhe nuk rezulton të jetë ankimuar.

Dosja nr. 2 – Procedimi penal nr. *** (vendosur pushimi i procedimit/akti - vendimi i pushimit)

Nga shqyrtimi i akteve ka rezultuar se punonjësit e INUV të Komunës Velipojë, Shkodër, kanë proceduar me praktika konstatimi për ndërtime pa leje të disa shtetasve në zonën e Velipojës, Shkodër.

Veprimet e para hetimore janë kryer prej policisë gjyqësore, është përpiluar procesverbali i konstatimit nr. ***, datë 16.4.2012, për ndërtimin e katit të dytë, proces me tulla dhe kolona, nga shtetasi B. Ll.. Është përpiluar edhe vendimi për prishje objekti nr. ***, datë 17.4.2012, si dhe vendimi për dënim me gjobë nr. ***, datë 17.4.2012. Mbi bazën e provave të administruara gjatë hetimit, prokurorja ka konkluduar që rezultonte e provuar që fakti ekzistonte, objekti trekat ishte ndërtuar pa leje ndërtimi. Kati i parë ishte ndërtuar para disa vitesh nga shtetasi B. Ll., ndërkohë që dy katet e tjera ishin ndërtuar pas vitit 2012 nga shtetasit F. dhe B. Ll..

Në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër, në datën 3.3.2014 është regjistruar procedimi penal për veprën penale “ndërtim i paligjshëm”. Subjekti i rivlerësimit, në datën 10.9.2014, është caktuar nga Drejtuesi i Prokurorisë për zgjidhjen ligjore të materialit kallëzues.

Në datën 14.10.2014 subjekti ka nxjerrë urdhrin “Për regjistrimin e procedimit penal” për regjistrimin e veprës penale “ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, por pa autor.

Subjekti ka përpiluar urdhrin për kryerjen e veprimeve hetimore, më 15.10.2014, me afat përfundimin e veprimeve në datën 10.11.2014.

Me urdhrin, datë 25.5.2015, subjekti ka kërkuar verifikimin e situatës pranë ALUIZN-it duke lënë afat përfundimtar datën 5.6.2015.

Në datën 15.7.2015 subjekti ka kërkuar administrimin e dosjes pranë ALUIZN-it me afat përfundimtar datën 25.7.2015 dhe më 27.5.2015 subjekti ka nxjerrë përsëri urdher për të njëjtin veprim duke lënë afat për përfundimin e hetimeve datën 7.9.2015.

Dokumenti ligjor “Vendim pushimi”, është i strukturuar në tri pjesë: pjesa hyrëse; pjesa përshkruese – arsyetuese; si dhe pjesën konkluduese.

Mbi bazën e provave të administruara gjatë hetimit, subjekti ka konkluduar që rezultonte e provuar që fakti ekzistonte, objekti 3-katësh ishte ndërtuar pa leje ndërtimi. Kati i parë ishte ndërtuar para disa vitesh nga shtetasi B. Ll., ndërkohë që dy katet e tjera ishin ndërtuar pas vitit 2012 nga shtetasit F. dhe B. Ll..

Subjekti ka analizuar përcaktimet ligjore të ligjit nr. 92/2015, “Për disa shtesa në ligjin nr. 22/2014, Për dhënie Amnistie”, neni 5, ku ishte parashikuar që: “... *amnistohen nga ndjekja penale të gjithë personat të cilët akuzohen se kanë kryer veprën penale ‘ndërtimit të paligjshëm’, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, në rastet kur vepra penale është kryer jo më vonë se data 10.4.2014”.*

Në dosje gjendet relacioni i oficerit të policisë gjyqësore, datë 16.4.2015, për përfundimin e hetimeve paraprake dhe pushimin e tij në lidhje me kallëzimin penal të vitit 2014, nga ku është konkluduar se shtetasit F. M. Ll. dhe B. R. Ll. kanë konsumuar elementët e veprës penale “ndërtim të paligjshëm”, të parashikuar në nenin 199/1/1 pasi kanë ndërtuar katin e dytë dhe të tretë mbi një ndërtim ekzistues pa pasur lidhje me truallin. Në mbështetje të nenit 5 të ligjit nr. 22/2014, “Për dhënie amnistie”, i cili ka hyrë në fuqi në datën 10.4.2014 thuhet se procedimi penal nuk mund të fillojë dhe nëse ka filluar duhet të pushojë për veprat penale të kryera deri në datën 31.12.2013, për të cilat Kodi Penal parashikon dënim deri në dy vjet ose çdo dënim tjetër më të lehtë.

Vepra penale sipas nenit 199/1/1 parashikon dënim penal me një vit burg, gjithashtu, vepra penale e regjistruar në bazë të procedimit penal nr. ***, të vitit 2014, nuk vërtetohet se është konsumuar deri më 31.12.2013, prandaj procedimi penal nr. *** nuk mund të vazhdojë dhe duhet pushuar.

Vendimi i pushimit është marrë në datën 11.9.2015 rreth një vit nga momenti kur i është caktuar subjektit (10.9.2014) prej Drejtuesit të Prokurorisë për zgjidhjen ligjore të materialit kallëzues.

Nuk rezulton që ky vendim të jetë ankimuar në gjykatë.

Në përfundim duket se:

- a) Subjekti ka regjistruar procedimin penal në datën 14.10.2014, rreth një muaj më vonë nga data kur i është caktuar ky material hetimor.
- b) Subjekti ka zvarritur hetimet për një periudhë njëvjeçare (10.9.2014 - 11.9.2015) pa shkak ligjor edhe pse ligji nr. 22/2014, “Për dhënie amnistie”, i cili ka hyrë në fuqi më 10.4.2014, parashikon se procedimi penal nuk mund të fillojë edhe nëse ka filluar duhet të pushojë për veprat penale të kryera deri në datën 31.12.2013, për të cilat Kodi Penal parashikon dënim deri në dy vjet ose çdo dënim tjetër më të lehtë.

Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të shpjeguar dhe provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

Në vijim të shpjegimeve të saj subjekti ka paraqitur argumenta sa vijon. Lidhur me regjistrimin e procedimit penal një muaj më vonë nga data kur i është caktuar ky material hetimor, ajo shpjegon se sapo është caktuar materiali kallëzues, ky i fundit i është deleguar menjëherë oficerit të policisë gjyqësore dhe që nga çasti i caktimit të materialit deri në datën e regjistrimit 14.10.2014 i është nënshtruar kryerjes së veprimeve të natyrës verifikuese në përputhje me parashikimet e pikës 2.3, të Udhëzimit nr. 3, datë 19.6.2012, të Prokurorisë së Përgjithshme: “Për një ndryshim dhe një shtesë në Udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale”. Veprimet verifikuese i janë deleguar oficerit të policisë gjyqësore me urdhrin datë 10.9.2014. Si rregull, procesi verifikues i shqyrtimit të materialit kallëzues i shërben për sa është e mundur në intervalin kohor 30-ditor që përcaktohet në udhëzim, evidentimit të elementëve thelbësorë të faktit për të konkluduar më pas me regjistrimin apo mosfillimin e procedimit penal. Në rastin konkret, materiali kallëzues nr. *** është regjistruar kryesisht nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër pas indicies se nga ana e punonjësve të Inspektoratit

Ndërtimor e Urbanistik Vendor Komuna Velipojë nuk ishin kallëzuar në prokurori të gjitha praktikat e mbajtura prej tyre me rastin e konstatimit të ndërtimeve pa leje, por vetëm një pjesë e tyre. Krahas këtij dokumentacioni, paraqitej i nevojshëm administrimi i dokumentacionit nga Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, institucion përgjegjës për dhënien e lejes së legalizimit në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.

Subjekti sqaron se rezultatet e këtyre veprimeve do të mundësonin evidentimin e faktit të ekzistencës së objektit pa leje, rrethanat në të cilat ishte konstatuar ndërtimi dhe personi që i atribuohet vepra penale dhe pas mbledhjes së këtyre të dhënave që arsyeshëm krijonin bazueshmërinë e dyshimit se ishte konsumuar vepra penale ‘ndërtim i paligjshëm’, u krye regjistrimi i procedimit penal me qëllim hetimin e rrethanave në të cilat ishte kryer ndërtimi i shtesës së katit të dytë me sip. 145 m², si dhe identifikimi i personit përgjegjës.

Për sa i përket konstatimit për zvarritjen e hetimeve, subjekti i rivlerësimit shpjegon: “... më lejoni të pohoj se nuk janë zvarritur hetimet për një periudhë njëvjeçare dhe vendimi është marrë bazuar në ligj dhe në kohën e duhur, pas kryerjes së hetimit të plotë e të gjithanshëm, i cili nxori në dritë pasaktësinë e dokumentacionit të mbajtur nga Inspektorati Ndërtimor Urbanistik lidhur me identifikimin e subjektit ndërtues dhe pamundësinë e shprehur të autoriteteve përgjegjëse shtetërore për të administruar dhe dhënë informacion konkret e të saktë lidhur me pronësinë e truallit mbi të cilin ngrihej objekti i dyshuar pa leje apo përkatësinë e tij. Drejtimi i hetimeve kanalizohet qartazi në formulimet e urdhrave me shkrim për vijimësinë e veprimtarisë hetimore. Hetimet janë procese komplekse dhe vlerësoj se prokurori nuk duhet të çdojë në cilësinë e ushtrimit të ndjekjes penale dhe nuk mund të marrë vendim përfundimtar pa kryer të gjitha veprimet hetimore të domosdoshme”.

Në përfundim Komisioni çmon se subjekti ka treguar se ka mungesë në aftësinë për të hetuar e marr urdhra e vendime në kohën e duhur, gjykim dhe sjellje të cekëta, si dhe një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e saj, duke u konsideruar si mangësi profesionale.

Dosja nr. 3 – Procedimi penal nr. *** (vendosur pushimi i procedimit penal/akti – vendimi i pushimit)

Nga shqyrtimi i akteve ka rezultuar se Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Shkodër ka paraqitur kallëzim penal ndaj shtetasit L. H.. Ky kallëzim është regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër në datën 29.2.2016 për veprën penale “mashtrimi në sigurime”, parashikuar nga neni 145 i Kodit Penal me argumentin se ky shtetas kishte falsifikuar të dhënat e sigurimit në punë për të përfituar pensionin e pleqërisë duke shkaktuar një dëm financiar ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore në vlerën 938,623 (nëntëqind e tridhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e njëzet e tre) lekë.

Drejtuesi i Prokurorisë ka caktuar subjektin për ndjekjen e procedimit penal më 19.5.2014 me urdhrin “Për caktimin e prokurorit” (duket se data e vendimit të administruar në dosje është e gabuar).

Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër është nxjerrë urdhri “Për regjistrimin e procedimit penal” në datën 29.2.2016, pa autor.

Me urdhrin për kryerjen e veprimeve hetimore datë 3.3.2016 është kërkuar të merret informacion nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Lezhë, të pyetet shtetasi L. H. nëse ka punuar në Ndërmarrjen Bujqësore ***, nëse ka përfituar asistencë, nëse disponon librezën e punës, nëse ka qenë banor i *** dhe nëse ka ankimuar vendimin e Drejtorisë Rajonale duke administruar certifikatën familjare brenda datës 18.3.2016.

Subjekti ka nxjerrë urdhrin “Për pushimin e procedimit penal” në datën 6.4.2016 për veprën penale “mashtrim në sigurime”, parashikuar nga neni 145 i Kodit Penal dhe ka njoftuar Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Shkodër më 4.5.2016.

Dokumenti ligjor “Vendim pushimi” është i strukturuar në tri pjesë: pjesa hyrëse; pjesa përshkuese; si dhe dispozitivi. Në dokument, fillimisht, përshkruhen rrethanat e faktit që kanë rezultuar nga aktet e referuara nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Shkodër.

Nga hetimet e kryera ka rezultuar se shtetasi L. H. figuronte i regjistruar në Regjistrin Themeltar të ish-Kooperativës Bujqësore *** për periudhën kohore 1962 – 1972, ndërsa për periudhën 1974 – 1989 figuronte i punësuar në ish-Kooperativën Bujqësore ***. Gjatë hetimit është konstatuar në bazë të Certifikatës së Gjendjes Civile, datë 21.3.2016, se shtetasi i kallëzuar, L. H., kishte ndërruar jetë në datën 4.9.2015.

Pas konstatimit të këtij fakti, prokurorja e çështjes ka konkluduar se hetimet e procedimit penal nr. *** duhej të pushoheshin, referuar germës “ë”, të nenit 328/1², të Kodit të Procedurës Penale dhe ka vendosur të pushojë procedimin në datën 6.4.2016.

Nuk rezulton të jetë bërë ankim në gjykatë ndaj vendimit të pushimit.

Dosje nr. 4 – Procedimi penal nr. *** (vendosur dërgimi për gjykim i procedimit penal /akti - kërkesë për gjykim)

Shtetasja V. L. ka kallëzuar në Komisarlatin e Policisë Shkodër bashkëshortin S. L. dhe vjehrrin M. L., për veprën penale “dhunë në familje”, të parashikuar nga neni 130/a, paragrafi i parë, i Kodit Penal, pasi pretendon se kishin ushtruar dhunë ndaj vajzave të tij. Kallëzuesja ka vënë në dijeni oficerët e policisë gjyqësore se për njërin nga episodet e dhunës kishte kallëzuar edhe më parë në polici dhe për atë rast bashkëshorti ishte proceduar dhe dënuar. Kallëzuesja ka shpjeguar se edhe gjatë vuajtjes së dënimit me kusht, bashkëshorti ka vazhduar kërcënimet dhe dhunën pasi ishte gjithë kohës i alkoolizuar.

Ka rezultuar se në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ishte regjistruar edhe procedimi nr. *** mbi bazën e kallëzimit të shtetasës V. L., për ushtrim të dhunës nga vjehri M. L.. Gjatë gjykimit të çështjes ka ndërruar jetë i pandehuri M. L. dhe, për këtë arsye, gjykata ka vendosur pushimin e çështjes penale për këtë të pandehur.

Urdhri “Për regjistrimin e procedimit penal” është nxjerrë në datën 13.5.2016 mbi kallëzimin e paraqitur më 11.4.2016 nga shtetasja V. L. për veprën penale “dhunë në familje” ndërsa në datën 13.5.2016 është nxjerrë urdhri “Për regjistrimin e procedimit penal” mbi kallëzimin penal datë 9.4.2016 për veprën penale “dhunë në familje”, parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal. Subjekti ka nxjerrë vendim për bashkimin e procedimeve penale nr. ***, viti 2016 dhe nr. ***, viti 2016.

Subjekti ka përpiluar urdhrin “Për kryerjen e veprimeve hetimore” në datën 15.5.2016 në të cilin ka kërkuar administrimin e fashikullit, si dhe pyetjen e personave brenda datës 20.5.2016.

Me urdhrin e datës 3.6.2016 është kërkuar të administrohet fashikulli, të pyetet kallëzuesja për arsyen pse nuk është paraqitur tek eksperti mjeko-ligjor, si dhe cilët ishin afër kur ndodhi ngjarja, duke lënë afat për përfundimin e hetimeve datën 3.6.2016.

Subjekti ka nxjerrë urdhra në vijim në datën 18.4.2016 duke kërkuar të administrohet vendimi për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes deri më 20.4.2016, si dhe për t’u administruar aktekspertimet mjeko-ligjore dhe vendimi gjyqësor që ka dënuar të kallëzuarin.

Kërkesa nr. *** “Për gjykimin e procedimit penal”, sipas nenit 130/a të Kodit Penal, për shtetasin M. L. u dërgua për gjykim dhe u është njoftuar shtetasve të interesuar.

Dokumenti ligjor “Kërkesë për gjykim” është i strukturuar në katër pjesë: pjesa hyrëse; pjesa përshkuese-arsyetuese; pjesa konkluduese; si dhe lista e provave. Subjekti ka përshkruar faktin e ndodhur, veprimet hetimore të kryera dhe provat e administruara, mbi bazën e të cilave provohet ekzistenca e faktit penal dhe përgjegjësia penale e të pandehurve. Pas njohjes së të

²Neni 328/1 në çdo fazë të procedimit, prokurori vendos pushimin e çështjes kur i pandehuri vdes.

pandehurve me aktet e çështjes në ngarkim të tyre, prokurorja ka vendosur dërgimin e çështjes për gjykim bazuar në nenin 331³ të Kodit të Procedurës Penale (2 muaj e 11 ditë).

Bazuar në kërkesën e dërguar për gjykimin e shtetasit S. L., Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur: Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit S. L., i akuzuar për veprën penale “dhunë në familje” të parashikuar nga neni 130/a/1 i Kodit Penal, pasi sipas nenit 388/d të Kodit të Procedurës Penale nuk provohet të ketë kryer vepra penale dhe është vlerësuar i pamjaftueshëm të provuarit e kryerjes së veprës penale nga i pandehuri vetëm me deklarin e kallzueses, pa e lidhur me prova të tjera dhe pa specifikuar rast konkret dhune.

Subjekti ka vlerësuar se kryerja e veprës penale nga i pandehuri S. L. është kryer nëpërmjet cenimit të integritetit psiko-emocional të kallzueses dhe vajzave të saj, fakt i provuar me vendimin nr. ***, datë 6.5.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për vërtetimin e Urdhrit të Mbrojtjes, lëshuar si rezultat i qëndrimit të vazhdueshëm agresiv të shtetasit S. L. ndaj familjes. Gjatë këtij gjykimi ishte administruar edhe raporti psikologjik i datës 6.5.2016, ku psikologia kishte konkluduar në ekzistencën e dhunës brenda familjes L.. Për këtë arsye, subjekti ka ankimuar vendimin nr. ***, datë 6.3.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, bazuar në nenin 408 të Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 31.5.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 6.3.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Ndaj këtij vendimi rezulton të jetë ushtruar rekurs nga prokurori i Apelit dhe çështja ndodhet në proces në Gjykatën e Lartë.

Rezulton se ankimi i prokurores është bërë në përputhje me udhëzimin nr. 1, datë 14.11.2008, “Për ushtrimin me eficiencë të së drejtës së ankimimit” e Prokurorit të Përgjithshëm. Sipas këtij udhëzimi, prokurori i seancës, si rregull, duhet të ushtrojë apel kur gjykata ka vendosur në kundërshtim me konkluzionet e tij përfundimtare.

Dosja nr. 5 – Procedimi penal nr. ***

Në datën 7.1.2014, punonjësit e Patrullës së Përgjithshme Shkodër kanë ndaluar shtetasin I. A., në drejtimin e një motomjeti tip “Honda”, pa targa dhe pa dokumentacion, ndërsa drejtuesi i automjetit, shtetasi I. A. nuk ishte i pajisur me leje drejtimi.

Për sa më sipër, në datën 8.1.2014 është regjistruar ndaj tij procedimi penal për veprën penale “drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal.

Nga OPGJ-ja janë mbajtur procesverbalet e datës 7.1.2014, për referimin e veprës në prokurori: për arrestimin në flagrancë të shtetasit I. A.; për kontrollin ndaj tij; si dhe procesverbali për sekuestrimin e provës materiale.

Me urdhrin për regjistrimin e procedimit penal subjekti ka regjistruar në datën 8.1.2014 aktet e kallzimit penal nr. ***, datë 8.1.2014, në ngarkim të shtetasit I. A. duke deleguar veprimet hetimore më 9.1.2014 me qëllim njoftimin e të pandehurit mbi kauzën.

Subjekti ka nxjerrë vendimin “Për marrjen e personit si të pandehur”, datë 9.1.2014, për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, i cili i është njoftuar të pandehurit dhe mbrojtësit.

Në lidhje me arrestimin në flagrancë të kryer nga policia gjyqësore, procedura është realizuar në respektim të kërkesave të parashikuara në nenet 251 dhe 252 të Kodit të Procedurës Penale, pasi ekziston gjendja e flagrancës në kryerje e sipër të veprës penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal. Subjekti ka trajtuar në detaje ekzistencën e kushteve të parashikuara në nenin 228 të Kodit të Procedurës Penale për caktimin e një mase sigurimi personal ndaj shtetasit të arrestuar, si dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova për kryerjen e një krimi, kushtet ligjore për marrjen në përgjegjësi penale dhe rrezikshmërinë e kryerjes së krimeve të të njëjtit lloj.

³Neni 331 i KPRP-së parashikon se: “Kur ka prova të plota për fajësinë e të pandehurit, prokurori paraqet kërkesën për gjykimin e çështjes”.

Subjekti ka vlerësuar brenda afatit ligjor se masa më e përshtatshme⁴ ishte ajo e arrestit në burg⁵, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale. Urdhri për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit Penal ndaj personit nën hetim mban datën 11.1.2014.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 11.1.2014, ka vendosur sipas kërkesës së subjektit duke vleftësuar të ligjshëm arrestimin në flagrancë të të pandehurit I. A., duke caktuar masën e sigurimit personal atë të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, si dhe duke pranuar kërkesën e saj për gjykim të drejtpërdrejtë të të pandehurit.

Me vendimin nr. ***, datë 20.1.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, i pandehuri I. A. është dënuar me 20 ditë burgim, pas aplikimit të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale duke zbritur 1/3 e dënimit.

Subjekti ka nxjerrë urdhrin nr. ***, datë 20.1.2014, “Për ekzekutimin e vendimit penal”, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Dokumenti ligjor “Kërkesë për vleftësimin e arrestit në flagrancë, caktimin e masës së sigurimit dhe gjykimin e drejtpërdrejtë të çështjes penale” është i strukturuar në pjesën hyrëse, pjesën përshkuese - arsyetuese dhe pjesën konkluduese.

Subjekti i rivlerësimit përshkruan faktin e ndodhur, veprimet hetimore të kryera dhe analizën ligjore mbi provat e administruara, mbi bazën e të cilave argumentohet plotësimi i kriterëve ligjore për arrestimin në flagrancë, plotësimi i kriterëve ligjore për caktimin e një mase sigurimi duke vlerësuar që masa më e përshtatshme është ajo e arrestit në burg, si dhe plotësimi i kriterëve ligjore për të proceduar me gjykimin e të pandehurit sipas përcaktimeve të nenit 400 e vijues të Kodit të Procedurës Penale.

Mbi bazën e akteve të administruara, subjekti ka vlerësuar të drejtë aplikimin e procedurës për gjykimin e drejtpërdrejtë, sipas përcaktimeve të nenit 400⁶ të Kodit të Procedurës Penale.

Kërkesa penale për arrestimin në flagrancë, caktimi i masës së sigurimit dhe gjykimi i drejtpërdrejtë i është komunikuar të pandehurit dhe mbrojtësit.

C. TË DHËNAT ARKIVORE (ankesat dhe masat disiplinore - vlerësimet)

1. Nga verifikimi në arkivin e Prokurorisë së Përgjithshme dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë rezulton se ndaj subjektit të rivlerësimit, prokurore Marsida Frashëri, me urdhrin nr. ***, datë 5.3.2014, të Prokurorit të Përgjithshëm, i është dhënë masa disiplinore “kalim në një detyrë tjetër më të ulët brenda sistemit të drejtësisë”, duke kryer detyrën e oficerit të policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, nga data 7.3.2014 deri në datën 7.9.2014.

1.1 Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar rezulton se me urdhrin nr. ***, datë 6.11.2013, të Prokurorit të Përgjithshëm është filluar procedimi disiplinor në ngarkim të subjektit të rivlerësimit. Procedimi disiplinor është filluar mbi bazën e të dhënave të akt kontrollit të datës 8.10.2013, i cili është iniciuar në zbatim të urdhrin nr. ***, datë 5.7.2013, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për ushtrimin e kontrollit të veprimtarisë së prokurores”.

1.2 Komisioni ka kërkuar informacion nga Prokuroria e Përgjithshme në lidhje me këtë masë disiplinore.

1.3 Prokuroria e Përgjithshme ka konfirmuar⁷ për Komisionin se bazuar në urdhrin nr. ***, datë 5.7.2013, të Prokurorit të Përgjithshëm u ushtrua kontrolli me objekt verifikimin e

⁴Neni 228 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se: “Masat e sigurimit personal vendosen: (a) kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës; (b) kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet; (c) kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet.

⁵Neni 230 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se: “Masa e sigurimit ‘arrest në burg’ mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të pandehurit”.

⁶Neni 400 i KPRP-së parashikon se: “1. Kur i pandehuri është arrestuar në flagrancë, prokurori mund ta paraqesë në gjykatë, brenda njëzet e katër orëve, kërkesën për vleftësimin e arrestit dhe gjykimin e njëkohshëm. 2. Në qoftë se arrestimi vleftësohet i drejtë dhe nuk ka nevojë për hetime të tjera, procedohet menjëherë në gjykim, ndërsa kur ai nuk gjendet i bazuar aktet i kthehen prokurorit. Por edhe në rastin e fundit, kur i pandehuri dhe prokurori japin pëlqimin gjykata procedon në gjykimin e drejtpërdrejtë”.

⁷Referojni shkresës nr. *** prot., datë 5.3.2022, të Prokurorisë së Përgjithshme.

kallëzimeve që ndodheshin në fazën e shqyrtimit, për të cilat ende nuk ishte vendosur regjistrimi ose mosfillimi i procedimit penal, procedimet penale që ndodheshin në fazën e hetimit paraprak dhe 20 procedime penale (procedimet penale: nr. *** datë 31.1.2012; nr. *** datë 16.5.2011; nr. ***, datë 1.11.2011; nr. ***, datë 20.10.2011; nr. ***, datë 26.7.2011; nr.*** datë 31.12.2012; nr. ***, datë 24.1.2012; nr. *** datë 30.9.2011; nr. ***, datë 14.11.2011; nr. ***, datë 31.7.2012; nr. ***, datë 10.9.2012; nr. ***, datë 4.7.2011; nr. ***, datë 7.00.2012; nr. ***, datë 11.7.2011; nr. ***, datë 11.7.2011; nr. ***, datë 11.7.2011; nr. ***, datë 11.7.2011; nr. ***, datë 19.4.2011; nr. ***, datë 17.5.2012; nr. ***, datë 31.7.2012) të referuara nga Drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Ka rezultuar nga inspektimi i volumit të punës së subjekti kishte në fazën e hetimeve paraprake 2 kallëzime dhe 26 procedime penale.

Gjatë vitit 2012 subjekti ka ushtruar ndjekjen penale në 74 procedime, ndër të cilat ka dërguar për gjykim 17 dhe ka pushuar 18, ka pezulluar 8 procedime penale, ka transferuar 3 procedime penale dhe ka mbartur për hetim për vitin 2013, 28 procedime penale.

Gjatë vitit 2013 subjekti ka ushtruar ndjekjen penale në 43 procedime penale, ndër të cilat ka dërguar për gjykim 4 procedime penale, ka pushuar 7 procedime, ka pezulluar 1 procedim, ka transferuar 1 procedim penal dhe ka mosfilluar dy procedime.

1.4 Me urdhrin nr. ***, datë 5.3.2014, “Për dhënie mase disiplinore” është vendosur masa disiplinore “kalim në një detyrë më të ulët brenda sistemit të prokurorisë”, duke kryer detyrën e oficerit të policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër në intervalin kohor 7.3.2014 - 7.9.2014.

1.5 Subjekti, në pretendimet e saj, ka deklaruar se nuk është respektuar procedura për fillimin e procedimit disiplinor pranë saj, pasi kjo procedurë duhet të iniciohet prej Prokurorit të Përgjithshëm. Subjekti pretendon se ka marrë një numër të konsiderueshëm dosjesh penale në dosjen e hetimit dhe njëkohësisht ka vazhduar të ushtrojë ndjekjen penale për çështje të tjera që ndodheshin në fazën e hetimit dhe gjykimit.

Përveç numrit të lartë të procedimeve, çështjet e marra për shkak të kohës së gjatë që kanë qëndruar nën hetim janë trajtuar me përparësi prej saj.

Subjekti ka pretenduar vështirësi në punë, për të cilën ka vendosur në dijeni institucionin me anë të kërkesave të saj për transferim.

1.6 Në përfundim, lidhur me këto verifikime, duket se:

a) Subjekti ka kryer shkelje të shumta dhe të ndryshme ligjore ku në disa procedime penale të ndjekura prej saj është vënë re neglizhencë e pajustificuar në fazën e regjistrimit të procedimit penal duke mos përmbushur detyrimet e parashikuara në nenin 287/1 të KPRP-së dhe të udhëzimit nr. 241, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale”.

b) Subjekti nuk ka kryer në plotshmëri dhe vijueshmëri veprimet e domosdoshme hetimore paraprake duke zvarritur në mënyrë të pajustificuar hetimet paraprake të procedimeve dhe duke treguar neglizhencë të pajustificuar për të marrë vendim përfundimtar.

1.7 Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar dhe shpjeguar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

1.8 Subjekti i rivlerësimit argumenton se kjo masë disiplinore është e paparashikuar në ndonjë ligj të miratuar dhe nga ana e saj është ankumuar në Gjykatën Administrative të Apelit dhe në Gjykatën e Lartë, të cilat në përfundim kanë konkluduar në favor të ish Prokurorit të Përgjithshëm A. Ll.. Sipas subjektit, kjo masë është ekzekutuar, është shuar që në datën 7.9.2015 dhe duhej të ishte fshirë nga dosja personale, si dhe ka ndikuar në vlerësimin e punës për vitin 2014 me nivelin “Mirë”. Subjekti shprehet se: “Juridikisht kjo masë nuk ka ekzistencë

prej vitesh dhe mbajtja ende e regjistruar si një e dhënë dokumentare merr përmasat e një 'ndëshkimi' de facto të parehabilitueshëm".

Në vijim të parashtrimeve të saj lidhur me rezultatin e hetimit dhe me masën disiplinore subjekti kërkon nga Komisioni që të mos konsiderohet me ndikim negativ në vlerësimin profesional duke pasur në konsideratë parimin e gjësë së gjykuar dhe parimin tjetër që rrjedh prej saj mosdënimin dy herë, sipas nenit 4, të Protokollit nr. 7, të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe praktikës së Komisionit me vendimin nr. 445, datë 16.9.2021.

1.9 Në përfundim Komisioni çmon se vlerësimi i mangësive të subjektit të rivlerësimit gjatë ushtrimit të detyrës bëhet për të kuptuar dhe vlerësuar ecurinë e saj në punë dhe aftësitë profesionale të saj, e ato organizative. Vlerësimi i këtij rasti (çështjet e trajtuara gjatë kontrollit) do të vlerësohen në vijimësi me veprimtarinë e saj të mëtejshme gjatë ushtrimit të detyrës së prokurorit.

2. Me vendimin nr. ***, datë 1.2.2019, të Prokurorit të Përgjithshëm është filluar hetimi disiplinor për prokuroren Marsida Frashëri, pas akteve dhe informacionit të dërguar nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

2.1 Komisioni ka kërkuar informacion nga Prokuroria e Përgjithshme në lidhje me relacionet për procedimin disiplinor, e cila e ka konfirmuar⁸ duke dërguar praktikën përkatëse.

2.2 Ka rezultuar që Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka nxjerrë urdhrin "Për ngritjen e Grupit të Punës", nr. ***, datë 6.9.2018, me objekt çeljen e zyrës së prokurores Marsida Frashëri dhe inventarizimin e akteve që ndodheshin në të, për shkak se prokurorja ishte caktuar përkohësisht në Prokurorinë e Përgjithshme si pjesë e grupit mbështetës për përgatitjen e vlerësimeve profesionale të prokurorëve, por nuk kishte kryer dorëzimin e materialeve që ndiqeshin prej saj. Pas çeljes së zyrës janë konstatuar kallëzime penale, procedime penale, akteksptime, përgjigje letërporosie dhe prova të ndryshme materiale që i përkisnin periudhës 2010 – 2017.

Këto materiale nuk ishin dorëzuar por janë mbajtur të mbyllura në zyrën e saj në raftet deri në momentin e konstatimit. Janë gjetur letërporosi dhe prova materiale. Nga verifikimi në regjistrin elektronik kallëzimeve nuk u ishte dhënë zgjidhje ligjore.

Lidhur me konstatimin është përpiluar procesverbali përkatës, i cili është dërguar së bashku me informacionin në Prokurorinë e Përgjithshme. Ky hetim disiplinor është mbyllur për arsye se mungonte kuadri ligjor rregullues për të mundësuar identifikimin e shkeljeve që përbëjnë shkak për nisjen e procedurave disiplinore.

2.3 Subjekti ka pretenduar se organi kompetent, sipas nenit 147/b i Kushtetutës për fillimin e hetimit disiplinor është Inspektori i ILD-së. Subjekti citon vendimin nr. 43, datë 10.4.2017, të Gjykatës Kushtetuese, i cili ka shfuqizuar nenet 101, 102, 103 dhe 104 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", ku parashikoheshin mënyrat apo rastet e shkeljeve disiplinore me argumentin se mënyra e formulimit të tyre nuk plotëson kërkesën kushtetuese për qartësi, qëndrueshmëri, besueshmëri dhe efektivitet, veçanërisht për shkak të rëndësisë që kanë për magjistratin pasojat që sjell shkelja disiplinore.

Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se terminologjia e përdorur dhe teknika legjislative e hartimit të tyre ngre dyshime serioze mbi kuptueshmërinë e ndryshme të tyre, çka mund të rezultojë me pasoja negative serioze për statusin e magjistratit dhe përfitimet që lidhen me të".

2.4 Kallëzimet penale dhe procedimet penale të cilat ishin caktuar për vlerësim dhe trajtim u janë caktuar prokurorëve të tjerë nga ku rezulton se:

2.4.1 Procedimi penal nr. ***, viti 2006, që bën fjalë për veprën penale "vjedhje", parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal, është mbajtur nga subjekti pa veprim deri në momentin që u

⁸Referojuni shkresës nr. *** prot., datë 3.3.2022, të Prokurorisë së Përgjithshme.

gjetën aktet në zyrë. Kjo dosje iu caktua prokurores B. H., e cila në datën 19.11.2018 vendosi pushimin e hetimeve pranë gjykatës kompetente, pasi ndjekja penale ishte parashkruar.

2.4.2 Procedimi penal nr. ***, viti 2011, që bën fjalë për veprën penale “vjedhje”, parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal, është mbajtur nga subjekti pa veprim deri kur u gjendën aktet në zyrë. Kjo dosje i ka kaluar prokurores B. H., e cila ka vendosur në datën 19.11.2018 pushimin e menjëhershëm të hetimeve pasi subjekti nuk kishte kryer asnjë veprim hetimor për rreth 7 vjet, duke u mbajtur nga ana e saj deri në parashkrimin e veprës penale.

2.4.3 Kallëzimi penal nr. ***, datë 2.11.2013 që bën fjalë për veprën penale “vjedhje e energjisë elektrike ose e impulseve elektronike”, parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal, është mbajtur nga subjekti pa veprim deri kur aktet janë gjendur në zyrë. Kjo dosje iu caktua prokurores B. H., e cila në datën 19.11.2018 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal sepse ndjekja penale ishte parashkruar. Subjekti nuk kishte kryer asnjë veprim hetimor, duke sjellë si pasojë parashkrimin e veprës penale.

2.4.4 Kallëzimi penal nr. ***, datë 17.11.2014, i bërë nga shtetasja A. D. për veprën penale “mosekzekutim pa shkaqe të përligjura i vendimit të gjykatës”, parashikuar nga neni 320/a i Kodit Penal. Kjo dosje i është caktuar prokurores E. C., e cila ka regjistruar procedimin penal nr. ***, të vitit 2018. Subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor duke mbajtur procedimin për 4 vjet, pa asnjë veprim.

2.4.5 Kallëzimi penal nr. ***, datë 9.3.2016, i bërë nga shtetasja R. L. për veprën penale “mashttrim kompjuterik”, e parashikuar nga neni 143/b/2 i Kodit Penal është mbajtur nga subjekti në zyrë pa veprim. Prokurore E. C. ka regjistruar procedimin penal nr. ***, të vitit 2018. Subjekti ka mbajtur procedimin pa veprim për dy vite.

2.4.6 Kallëzimi penal nr. ***, viti 2012, është mbajtur pa veprim deri kur janë gjendur aktet në zyrë. Kjo dosje i është caktuar prokurores E. C., e cila ka regjistruar procedimin penal nr. ***, të vitit 2018. Subjekti nuk kishte kryer asnjë veprim hetimor duke u mbajtur nga ana e saj për dy vite.

2.4.7 Kallëzimi penal nr. ***, datë 13.9.2016, për veprën penale “dëmtime të tjera me dashje”, parashikuar nga neni 90 i Kodit Penal është mbajtur nga subjekti pa veprim deri kur janë gjendur aktet në zyrë. Kjo dosje iu caktua prokurores E. C., e cila ka regjistruar procedimin penal nr. ***, të vitit 2018. Subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor për dy vite.

2.4.8 Kallëzimi penal nr. ***, datë 24.2.2012 për veprën penale “prodhim dhe mbajtje e armëve luftarake”, parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal është mbajtur nga subjekti deri kur iu gjendën aktet në zyrë. Kjo dosje iu caktua prokurores E. C., e cila ka regjistruar procedimin penal nr. ***, të vitit 2018. Subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor duke e mbajtur dosjen pa veprim për gjashtë vjet.

2.4.9 Procedimi penal nr. ***, i vitit 2011, që bën fjalë për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal në ngarkim të shtetasit E. E., është mbajtur pa veprim prej subjektit deri kur janë gjendur aktet në zyrë. Kjo dosje i ka kaluar prokurorit A. M., i cili e ka pushuar me vendimin e pushimit datë 27.11.2018, për shkak të tejkalimit të afateve të ushtrimit të ndjekjes penale. Subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor duke e mbajtur nga ana e saj për shtatë vite.

2.4.10 Procedimi penal nr. ***, i vitit 2015, që bën fjalë për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal në ngarkim të shtetasit E. S., është mbajtur nga subjekti pa veprim deri kur i janë gjendur aktet në zyrë. Ky procedim penal i është ngarkuar prokurorit A. M. në datën 13.11.2018. Ky procedim është pushuar me kërkesë në gjykatë për pushimin e çështjes në datën 27.11.2018. Subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor duke e mbajtur dosjen pa veprim për tri vite.

2.4.11 Procedimi penal nr. ***, i vitit 2016, që bën fjalë për veprën penale të parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal në ngarkim të shtetasit E. G., është mbajtur nga subjekti pa veprim

deri kur iu gjenden aktet në zyrë. Së fundmi, kjo dosje i është caktuar prokurorit A. M. në datën 13.11.2018. Ky procedim penal është dërguar në gjykatë me kërkesën për pushimin e çështjes datë 14.12.2018. Subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor duke u mbajtur nga ana e saj për dy vite.

2.4.12 Kallëzimi penal nr. ***, datë 19.6.2017, që bën fjalë për veprën penale të parashikuar nga neni 321 i Kodit Penal, është mbajtur nga subjekti pa veprim deri kur iu gjenden dosjet në zyrë. Kjo dosje i është caktuar prokurorit A. M. në datën 13.11.2018, i cili e ka regjistruar më 26.11.2018 si procedim penal nr. 2006, viti 2018. Ky procedim është dërguar në gjykatë me kërkesë për pushimin e çështjes, datë 7.12.2018. Subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor duke mbajtur dosjen pa veprim për një vit.

2.4.13 Kallëzimi penal nr. ***, datë 11.9.2017, që bën fjalë për veprën penale të parashikuar nga neni 124 i Kodit Penal është mbajtur nga subjekti pa veprim deri kur i janë gjendur aktet në zyrë. Kjo dosje i është caktuar prokurorit A. M., i cili këtë kallëzim e ka marrë në datat 13.11.2018 dhe 26.11.2018 e ka regjistruar si procedim penal nr. ***, viti 2018. Ky procedim është në hetim drejt përfundimit të hetimeve dhe dërgimit për gjykim. Subjekti e ka mbajtur materialin hetimor pa veprim për një vit.

2.4.14 Kallëzimi penal nr. ***, datë 12.9.2017, që bën fjalë për veprën penale të parashikuar nga nenet 101/1 dhe 22 të Kodit Penal, është mbajtur në zyrë nga subjekti pa veprim deri në momentin kur aktet iu gjenden në zyrë.

Kjo dosje i ka kaluar për veprime prokurorit A. M. në datën 13.11.2018 dhe më 26.11.2018 e ka regjistruar si procedim penal nr. ***, viti 2018 për nenet 101/1 dhe 22 të Kodit Penal. Ky procedim penal është pezulluar për moszbulim autori në datën 26.12.2018. Subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor për një vit.

2.4.15 Kallëzimi penal nr. ***, datë 4.10.2017, që bën fjalë për veprën penale të parashikuar nga neni 121/a/1 i Kodit Penal, është mbajtur nga subjekti pa veprim deri kur iu gjenden aktet në zyrë. Kjo dosje i është caktuar prokurorit A. M., i cili e ka marrë në datën 13.11.2018 dhe më 26.11.2018 e ka regjistruar si procedim penal nr. ***, viti 2018. Ky procedim penal është mbajtur nën hetim. Subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor duke u mbajtur prej saj për një vit.

2.4.16 Prokurorit O. R. i kanë kaluar dosjet e mbartura të subjektit. Lidhur me procedimet penale nr. ***, të vitit 2010 dhe nr. ***, të vitit 2011, nga ana e tij është proceduar me kërkesë drejtuar gjykatës për pushimin e procedimeve penale për shkak të tejkalimit të afateve të parashkrimit të ndjekjes penale. Lidhur me materialet hetimore nr. *** dhe nr. *** të vitit 2012, nga ana e tij janë regjistruar procedimet penale nr. ***, datë 3.12.2018 dhe nr. ***, datë 3.12.2018, meqenëse ka vlerësuar se ka nevojë për kryerjen e veprimeve hetimore.

Lidhur me procedimin penal nr. ***, të vitit 2018 është hartuar urdhri për kryerjen e veprimeve hetimore, ndërsa për materialin nr. ***, datë 20.3.2012, është përpiluar urdhri për verifikim. Subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor duke i mbajtur në zyrë prej saj.

2.4.17 Procedimi penal nr. *** është regjistruar për veprën penale “trafikim të mjeteve motorike” sipas nenit 141/a të Kodit Penal duke caktuar për ndjekje subjektin e rivlerësimit. Pas rishortimit i ka kaluar prokurorit Xh. L.. Ky procedim është pezulluar në datën 25.7.2011 në pritje të letërporosisë nga autoritetet sllovene.

Në datën 8.3.2012 i është kthyer përgjigje letërporosisë së kërkuar, është administruar dosja nga subjekti dhe në datën 7.2.2013 është marrë deklaram për marrjen e të dhënave nga përkthyesi H. Q. lidhur me përkthimin e akteve, të cilat i ka pranuar t’i përkthejë por nuk është administruar në dosje përkthimi i akteve. Subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor për pesë vite.

- 2.4.18** Kallëzimi penal nr. *** është mbajtur nga subjekti për dy vite pa veprime dhe pas rihedhjes në short është mosfilluar procedimi prej prokurorit Xh. L. në datën 21.11.2018.
- 2.4.19** Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, bazuar në materialin kallëzues të ardhur nga Komisariati i Policisë Shkodër me shkresën nr. *** prot., datë 27.9.2016, ka regjistruar kallëzimin penal të sipërcituar në datën 27.9.2016 dhe i ka kaluar për verifikim subjektit më 29.9.2016, e cila nuk ka disponuar lidhur me mënyrën e përfundimit të këtij materiali kallëzues për dy vite. Ky material i ka kaluar me short prokurorit E. L., i cili ka dërguar në gjykatë kërkesën për pushimin e çështjes.
- 2.4.20** Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, mbi aktet e referuara nga OPGJ-ja Shkodër ka regjistruar procedimin penal nr. ***, datë regjistrimi 12.9.2014, për veprat penale “kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik”, “shkatërrimi i pronës” dhe “prishje e qetësisë publike”, parashikuar nga nenet 236, 150 dhe 274 të Kodit Penal në ngarkim të shtetasve A. Ç., E. A., G. Ç., A. R., N. D., A. M., A. Pr., S. R., A. L., D. K., N. D., J. Zh. dhe Z. K., ndaj të cilëve janë caktuar dhe masa sigurimi. Për hetimin e kësaj çështjeje janë ngarkuar prokurorët Marsida Frashëri, V. S., F. L. dhe E. C..
- Nga subjekti janë përpiluar vendimet për zgjatjen e hetimeve të datës 12.12.2014 me afat deri në datën 12.3.2015, vendim tjetër i datës 12.3.2015 me afat deri më 12.6.2015, dhe nuk ka vendim tjetër të zgjatjes së hetimeve. Në datën 9.3.2015 është përpiluar vendimi për marrjen e personit si të pandehur të shtetasit E. A. dhe pyetur ky person i cili ka kërkuar kohë për të gjetur avokat, por nuk rezulton të jetë bërë përfundim i hetimeve për të.
- Nga këqyrja e akteve rezulton të ketë procesverbal të pyetjes si të pandehur M. B. dhe A. Ç. të datës 12.3.2015, por nuk rezulton të ketë vendim për njoftimin e akuzës të këtyre shtetasve në fashikullin e procedimit dhe nuk rezulton gjithashtu të jetë bërë përfundim i hetimeve.
- Për sa i takon çështjes në tërësi konstatohet se është plotësuar afati dyvjeçar më 12.9.2016 që ishte afati maksimal që fashikulli i procedimit penal të dërgohej për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe, pas këtij afati, personat e marrë si të pandehur nuk mund të merren më për shkak të mbarimit të afatit dyvjeçar nga data e regjistrimit të emrave si persona që u atribuohet vepra penale. Prokurori E. L. ka përpiluar kërkesën drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për pushimin e çështjes penale.
- 2.4.21** Procedimi penal nr. ***, i vitit 2011, i regjistruar për kundërvajtjen penale “mbajtje pa leje të municioneve luftarake”, parashikuar nga neni 278/3 i Kodit Penal. Nga subjekti është nxjerrë vendimi për marrjen si të pandehur dhe njoftimin e akuzës në datën 17.2.2012 për shtetasin K. D., i cili është pyetur në cilësinë e të pandehurit, por procesverbali nuk ka të përcaktuar datën, muajin dhe vitin. Prokurori E. L., në datën 26.11.2018 ka përpiluar vendimin e pushimit të çështjes penale për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale. Subjekti ka mbajtur dosjen hetimore pa veprime për gjashtë vite.
- 2.4.22** Kallëzimi penal nr. ***, datë 31.5.2011, me objekt veprën penale “falsifikim të dokumenteve shkollore”, parashikuar nga neni 187 i Kodit Penal, është mbajtur nga subjekti pa veprim deri kur janë gjetur aktet në zyrë. Për kryerjen e veprimeve në ngarkim të kësaj çështjeje u caktua prokurori A. P., e cila në lidhje me këtë kallëzim ka disponuar me vendimin “Për mosfillimin e procedimit”. Subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor duke mbajtur materialin hetimor për shtatë vite.
- 2.4.23** Kallëzimi nr. ***, datë 25.6.2013, është mbajtur nga subjekti pa veprim deri kur iu gjendën aktet në zyrë dhe kjo dosje iu caktua prokurorës A. P., e cila ka disponuar me vendim “Për mosfillimin e procedimit penal”. Subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor duke mbajtur dosjen pa veprim për gjashtë vite.
- 2.4.24** Kallëzimi nr. ***, datë 16.3.2012, është mbajtur nga subjekti pa veprim deri kur iu gjendën aktet në zyrë. Prokurorja A. P. ka disponuar me vendim “Për mosfillimin e procedimit

penal”. Subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor duke u mbajtur nga ana e saj për gjashtë vite.

2.4.25 Kallëzimi nr. ***, datë 29.7.2011, me objekt veprën penale “prodhim dhe shitje e ushqimeve dhe e lëndëve të rrezikshme për shëndetin”, të parashikuar nga neni 288 i Kodit Penal, është mbajtur në zyrë pa veprim prej subjektit. Kjo dosje i ka kaluar prokurores A. P., e cila ka disponuar me vendim “për mosfillim procedimi”. Subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor duke u mbajtur prej saj për shtatë vite.

2.4.26 Procedimi penal nr. ***, datë 16.1.2012, me objekt veprën penale “veprime arbitrare”, të parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal. Kjo dosje është mbajtur pa veprim prej subjektit deri kur janë gjetur aktet në zyrë dhe i është caktuar prokurores A. P., e cila ka disponuar me kërkesë për pushimin e hetimeve drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor duke u mbajtur nga ana e saj për gjashtë vjet.

2.5 Në përfundim ka rezultuar se:

a) Në mënyrë të përsëritur dhe sistematike subjekti nuk ka respektuar parashikimet ligjore të neneve 291/1, 323 dhe 324 të Kodit të Procedurës Penale (i ndryshuar), pasi në kallëzimet penale nr. ***, nr. ***, nr. ***, nr. ***, nr. ***, nr. *** dhe nr. *** nuk ka bërë veprime hetimore për një periudhë që varion nga 1-7 vite, për të cilat çështja u parashkrua nga prokurorë të tjerë.

b) Subjekti ka zvarritur për afate të gjata kohore procedimet penale duke mos kryer asnjë veprim hetimor për kallëzimet penale nr. ***, nr. ***, nr. ***, nr. ***, nr. ***, nr. ***, nr. ***, nr. *** dhe nr. *** subjekti nuk ka bërë asnjë veprim për një periudhë 1- 6 vite, të cilat janë rihedhur në short nga prokurorë të tjerë në vitin 2018.

c) Subjekti, në disa në raste, nuk ka dërguar çështjen për gjykim brenda afateve ligjore. Dy procedime penale (nr. *** dhe nr. *** kanë qenë ende nën hetim dhe nuk ka vendim përfundimtar për to).

ç) Në dhjetë procedime penale (nr. ***, nr. ***, nr. ***, nr. ***, nr. ***, nr. ***, nr. ***, nr. ***, nr. *** dhe nr. ***) subjekti nuk ka kryer veprime hetimore për një periudhë 1-7 vite, për të cilat është kërkuar pushimi i çështjes në gjykatë pasi janë parashkruar.

d) Tri kallëzime penale janë regjistruar pas hedhjes në short në vitin 2018, kallëzimi penal (nr. ***, datë 19.6.2017) ku është kërkuar miratimi i vendimit të pushimit nga prokurori që iu ngarkua, kallëzimi penal (nr. ***, datë 12.9.2017) është pezulluar çështja “për moszbulim autori”, si dhe kallëzimi penal (nr. ***, datë 11.9.2017) është përfunduar prej një prokurori tjetër.

2.6 Komisioni ka kërkuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër fashikujt penalë për disa nga procedimet penale të mësipërme dhe nga përgjigjet e ardhura ka rezultuar e njëjta situatë faktike e referuar më lart.

2.7 Në përfundim të verifikimeve duket se subjekti i rivlerësimit ka treguar neglizhencë të plotë dhe pakujdesi duke “braktisur” dosjet kur është larguar nga zyra, duke neglizhuar dorëzimin dhe duke shkaktuar “vdekjen e tyre procedurale”.

2.8 Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 për të provuar dhe shpjeguar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

2.9 Lidhur me konstatimin për zvarritjen e disa çështjeve penale, subjekti i rivlerësimit shpjegon se mosmarrja e vendimeve në afat ka ardhur si rrjedhojë e mosvlerësimit në kohën e duhur në ndikimin e rrethanave objektive dhe subjektive (mungesa e kohës fizike për shkak të volumit të punës, kushtet e papërshtatshme të punës si pasojë e largësisë së vendit të punës dhe moskompensimit në ndonjë formë të saj, dinamikës së veprimtarisë hetimore apo procedurave në gjykatë). Subjekti sqaron se urdhri i Prokurorisë së Përgjithshme për caktimin e Grupit të Punës në janar të vitit 2018 ka pasur efekt të menjëhershëm dhe nuk përcaktonte as afat

kohëzgjatjeje. Për rrjedhojë, ishte e pamundur fizikisht kryerja e procedurave të dorëzimit të të gjitha materialeve brenda pak orëve, kur pjesa më e madhe ishte e deleguar për veprime shërbimeve të policisë gjyqësore. Subjekti i rivlerësimit shprehet se: *“Sa më sipër, nëse braktisja e dosjeve, sikurse konstaton Komisioni, nënkupton largimin nga zyra e Prokurorisë Shkodër në Zyrën e Prokurorisë së Përgjithshme, atëherë e njëjta gjë do të vlente edhe nëse unë do të vijoja të mos paraqitesha në detyrën e përcaktuar nga Prokurori i Përgjithshëm, veçanërisht në një proces kaq jetësor të sistemit të ri të drejtësisë”*.

Në vijim, subjekti sqaron se e kupton që situata mund të ishte tejkaluar në formë tjetër dhe zgjidhja mund të gjendej duke u angazhuar me sakrificë jashtë orarit të punës apo në ditë pushimi, por që në kushtet e atëhershme nuk u realizua. Subjekti i rivlerësimit shprehet se: *“Natyrisht, konstatimet e përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm në nisjen e procesit disiplinor ndaj meje dhe ato të Komisionit se janë kryer shkelje të afateve të hetimit, i kam të pranuar; absolutisht që nuk më krenojnë dhe arsyeshmë mund të ndikojnë në perceptime që në dukje zhvlerësojnë të gjithë punën time përgjatë gjithë këtyre viteve të kryer me përkushtim, ndershmeri, vetëmohim, integritet dhe profesionalizëm”*.

Në përfundim, subjekti i rivlerësimit shprehet se: *“Në pozitat e pranimi të kësaj situate, në vija të përgjithshme të konstatimeve, ju kërkoj të vlerësoni këtë tregues të punës sime në nivel makro, duke e parë atë të lidhur domosdoshmërisht me treguesit e tjerë të veprimtarisë sime profesionale, të cilët në tërësinë e tyre dhe në shtrirjen e problematikave të theksuara organizative, infrastrukurore dhe funksionale që kanë karakterizuar Sistemin e Prokurorisë në kohën e parareformës, shkrihen në trajtën e një produkti, i cili gëzon vlerat e mirënjohura nga Parimet e Bangalores të Sjelljes së Gjyqësorit ku integriteti është themelor në përmbushjen e detyrimeve, me gjithë gabimet dhe nevojat për përmirësim, të cilat janë të pashtershme”*.

2.10 Në përfundim është konstatuar se subjekti ka mbajtur në zyrën e saj fashikuj hetimorë të cilët ishin në proces apo për të cilët nuk kish ndërmarr asnjë veprim hetimor, duke treguar mungesë të theksuar të aftësive për administrimin e dosjeve gjyqësore, duke shmangur ngarkesën në punë, neglizhencë të paarsyeshme për zgjidhjen e çështjeve, duke shmangur rrethana që kanë efekt negativ në rezultatet e vlerësimit të saj.

3. Me vendimin nr. ***, datë 10.7.2019, të Prokurorit të Përgjithshëm është filluar hetimi disiplinor për prokuroren Marsida Frashëri, pas akteve dhe informacionit të dërguar nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 7.6.2019. Ka rezultuar se Drejtuesi i Prokurorisë kishte përjashtuar nga shorti procedimet penale në hetim dhe gjykim që ndiqeshin nga prokurori V. S., pasi ai ishte emëruar anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

3.1 Me urdhrin nr. ***, datë 26.4.2019, “Për përjashtimin e fashikujve nga shorti”, Drejtuesi i Prokurorisë ka urdhëruar përjashtimin nga shorti për fashikujt e procedimit penal, ushtrimi i ndjekjes penale të të cilëve do të kryhej nga prokurori V. S., duke caktuar subjektin Marsida Frashëri për ndjekjen e procedimeve për shkak se ishte kthyer për ushtrimin e detyrës pas kryerjes së funksioneve në Prokurorinë e Përgjithshme dhe nuk kishte ngarkesë pune.

3.2 Nga prokurorja Marsida Frashëri, me shkresën e datës 14.5.2019, është refuzuar⁹ urdhri i Drejtuesit të Prokurorisë Shkodër për përjashtimin e dosjeve nga shorti duke mos marrë ngarkesën e punës me pretendimet se:

a) Prokurori i Përgjithshëm nuk ka kompetencë për fillimin e procedimit disiplinor pasi kjo kompetencë sipas Kushtetutës i takon Inspektorit të Lartë të ILD-së, i cili emërohet brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 76/2016.

⁹Referojuni shkresës nr. *** prot., datë 3.3.2022, të Prokurorisë së Përgjithshme.

b) Urdhri nr. ***, datë 26.4.2019, “Për përjashtimin e fashikujve të procedimit penal nga shorti” i Drejtuesit të Prokurorisë është i pavlefshëm, pasi është nxjerrë në kundërshtim me ligjin¹⁰ dhe subjekti titullar nuk përmbush kriterin formal minimal ligjor për kryetar zyre.

c) Ky drejtues i përkohshëm ka mbajtur një qëndrim arbitrar dhe subjektiv sepse ka shmangur shortimin e procedimeve penale që kishte dorëzuar prokurori V. S..

3.3 Për sa më sipër, me vendimin nr. ***, datë 10.7.2019, të Prokurorit të Përgjithshëm është filluar hetimi disiplinor dhe me vendimin nr. ***, datë 10.1.2020, “Për mbylljen e hetimit disiplinor” ka vendosur mbylljen¹¹ e hetimit disiplinor të filluar ndaj saj, me arsyetimin¹² se gjatë periudhës kohore kur janë kryer shkeljet e referuara, mungonin dispozitat ligjore për përgjegjësinë disiplinore të magjistratëve.

Në Udhëzimin nr.3, datë 29.12.2016, “Për shpërndarjen e çështjeve në Prokurori”, parashikohet se: *“Kur janë rastet ligjore të zëvendësimit të prokurorit, në përzgjedhjen me short të prokurorit që do t’i caktohet çështja, Drejtuesi i Prokurorisë mban parasysht një trajtim të njëjtë mes prokurorëve duke konsideruar ngarkesën e secilit dhe seksionin përkatës”*.

3.4 Në përfundim të verifikimeve nga dokumentacioni i administruar duket se subjekti i rivlerësimit Marsida Frashëri, pa arsye nuk ka pranuar të marrë në dorëzim materialet hetimore duke mosrespektuar, udhëzimin nr. 3, datë 29.12.2016, të sipërcituar.

3.5 Komisioni i kaloi barrën e provës subjektivit të rivlerësimit në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 për të provuar dhe shpjeguar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

3.6 Subjekti i rivlerësimit, lidhur me barrën e provës, shpjegon se këta fashikuj nuk iu vunë ndonjëherë fizikisht në dispozicion në asnjë moment dhe nuk ka asnjë parashikim ligjor që detyron prokurorin të zbatojë urdhrin e Drejtuesit të Prokurorisë për përjashtimin e fashikujve të procedimit penal nga shorti. Subjekti shprehet se: *“I nderuar Komision, nuk duhet të vihem unë para përgjegjësisë për të justifikuar keqmenaxhimin që ky ish-kryetar i bëri Prokurorisë dhe arsyet përse nuk zbatova urdhrin e tij haptazi të paligjshëm. Me veprimet e mia kam respektuar parimin e pavarësisë procedurale/funksionale të prokurorit me kufizimin e respektimit të ligjit dhe përcaktimit të parashikuar në pikën 2, të nenit 6, të ligjit nr. 97/2016 ku thuhet shprehimisht: “Prokurorët u nënshtrohen udhëzimeve të përgjithshme me shkrim të prokurorit më të lartë, sipas dispozitave të këtij ligji”. Disponimi me ‘urdhër’ nga Drejtuesi i Prokurorisë për prokurorët e tjerë nuk ekziston më, falë ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore në kuadër të Reformës në Drejtësi. Gjithashtu, ‘shorti’ garanton paaftësinë dhe pavarësinë funksionale të prokurorëve që në fazën fillestare të shpërndarjes së çështjeve, kur përcaktohet ‘prokurori natyral’ i çështjeve, i njëjti standard sikurse për gjyqtarët. Këmbëngulja për të kundërtën, së paku reflekton paaftësi ekstreme në të kuptuarin e ligjit, për të mos thënë vullnet/dashje për të cenuar këtë pavarësi të prokurorit”*.

3.7 Në vijim, subjekti sqaron se i ka kërkuar verbalisht Drejtuesit të Prokurorisë të rishihte urdhrin dhe të hidhte shortin, duke i argumentuar se formalisht ky urdhër ishte nul dhe se shorti ishte ai që ingranonte në angazhimin për vijimin e ushtrimit të ndjekjes penale për çështjet që kishin kohë në ndjekje nga prokurorët e tjerë. Subjekti shprehet se nga përgjigjja kontradiktore e Drejtuesit të Prokurorisë u gjend para pafuqisë juridike për të zgjidhur problematikën që u shkaktua nga ky urdhër, haptazi i paligjshëm.

3.8 Subjekti argumenton se nëse do të kishte pranuar çështjet pa iu nënshtuar shortit do të gjendej para detyrimit për të marrë në ngarkim 171 fashikuj brenda ditës. Subjekti shprehet se:

¹⁰Bazuar në nenin 160/5 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” parashikohet se “Deri në krijimin e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, Këshilli i Lartë të Drejtësisë dhe Prokurori i Përgjithshëm heton shkeljet disiplinore nëpërmjet inspektorëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm bazuar në procedurën dhe kriteret e pjesës V dhe dispozitës kalimtare të këtij ligji.

¹¹Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 34, datë 10.4.2017 ka shfuqizuar nenin 101, 102, 103 dhe 104 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ku parashikoheshin se: Mënyra e formulimit të tyre nuk plotëson kërkesën kushtetuese për qartësi, qëndrueshmëri, besueshmëri dhe efektivitet. Veçanërisht për shkak të rëndësisë që kanë për magjistratin pasojat që sjell shkelja disiplinore.

Gjykata vlerëson se terminologjia e përdorur dhe teknika legjislatve e hartimit të tyre ngre dyshime serioze mbi kuptueshmërinë e ndryshme të tyre çka mund të rezultojë me pasojë negative serioze për statusin e magjistratit dhe përfitimet që lidhen me të.

¹²Prokurori i Përgjithshëm ka vendosur duke iu referuar respektimit të parimit të ligjshmërisë dhe parimit të “mosdënimit pa ligj”, parashikuar në pikën 1, germa “b”, të nenit 100 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe pikën 1, germat “d” e “dh”, të nenit 120 të këtij ligji.

“Kjo situatë do të më vendoste para një ngarkese pune të paprecedentë brenda një dite të vetme, e cila potencialisht kishte të gjitha premiset për të penguar ecurinë normale të veprimtarisë, për të cenuar të drejtat e palëve në proces dhe për të më përballur më vonë me procese disiplinore për shkak të mosrealizimit me të njëjtin ritëm të detyrave që lindnin dhe duhej të përfundonin njëkohësisht për 171 materialet. Procedura e zëvendësimit të prokurorit fillon me dorëzimin e çështjeve, vijon me ndarjen në grupe sipas seksioneve, grupveprave penale, më pas vazhdon me hedhjen e tyre në short, i cili përcakton prokurorin zëvendësues dhe detyron Drejtuesin e Prokurorisë të marrë vendimin për zëvendësimin e prokurorit me prokurorin që rezulton nga shorti dhe jo prej vullnetit të tij”.

3.9 Në përfundim, Komisioni çmon se veprimet e subjektit të rivlerësimit të vlerësuara në tërësinë e tyre, së bashku edhe me sjelljen e saj të vazhduar në institucionin ku ajo ushtronte detyrën e saj si prokurore (prokuroria Shkodër), tregojnë cilësi e aftësi të pamjaftueshme në punë e që çenojnë efektivitetin dhe efikasitetin e institucionit në tërësi dhe të saj si prokurore në veçanti.

4. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë ka regjistruar materialin kallëzues nr. *** të shtetas A. B. ndaj prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ndër ta edhe subjekti i rivlerësimit.

4.1 Prokurori i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, pasi ka shqyrtuar aktet e administruara, ka konkluduar se nuk konstatohej kryerja e ndonjë veprë penale nga prokurorët që kanë trajtuar kallëzimet e shtetas A. B.. Ka rezultuar se kallëzuesja ishte njoftuar mbi vendimmarrjen e prokurorëve, duke pasur mundësinë dhe të drejtën ligjore për t’i ankimuar në gjykatë. Në datën 15.1.2018 është vendosur mosfillimi i procedimit penal nr. ***, bazuar në nenet 290/1, germa “ç” dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale.

5. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, me shkresën nr. ***, datë 4.5.2020, ka informuar se ka regjistruar procedimin penal nr. ***, viti 2018, aktet e të cilit janë transferuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

6. Sipas informacionit nga Prokuroria e Përgjithshme, rezulton se për subjektin e rivlerësimit Marsida Frashëri kanë ardhur gjashtë praktika me ankesa nga disa shtetas.

6.1 Praktika nr. ***, e regjistruar në bazë të ankesës së shtetasit Xh. H.. Ankuesi ka parashtruar pretendime në lidhje me zvarritjen e hetimeve nga prokurorja Marsida Frashëri në lidhje me kallëzimin e bërë nga banorët e pallatit nr. ***, në lagjen “****”, për ndërtimin e një objekti pa leje nga njëri nga banorët e katit të parë të pallatit. Me shkresën nr. ***, datë 10.6.2015, Drejtoria e Kontrollit dhe Ndjekjes Penale në Prokurorinë e Përgjithshme, ka dërguar për kompetencë dhe zgjidhje ankimin e shtetasit Xh. H. në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, duke njoftuar ankuesin dhe arkivuar praktikën.

6.1.1 Nga dokumentacioni i administruar në dosje konstatohet se në datën 2.10.2014 është mbajtur procesverbali për kallëzimin verbal të veprës penale nga OPGJ dhe në datën 16.1.2015 është regjistruar procedimi penal nr. *** për veprën penale “ndërtim i paligjshëm”.

6.1.2 Nga shkresa nr. *** prot., datë 27.3.2015, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër përcaktohet se procedimi penal është nën hetim.

6.1.3 Në përfundim të verifikimeve Komisioni konstaton se:

- a) procedimi penal është regjistruar në datën 16.1.2015, rreth 3 muaj me vonë nga momenti i kallëzimit;
- b) deri në datën 27.3.2015 duket se nuk është kryer asnjë veprim hetimor;
- c) duket se subjekti ka zvarritur hetimet.

6.1.4 Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 për të provuar dhe shpjeguar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

6.1.5 Subjekti i rivlerësimit, lidhur me konstatimin për zvarritje hetimi, shpjegon se materiali kallëzues është caktuar në datën 13.4.2014 dhe, po në këtë datë, i është deleguar me urdhër oficerit të policisë gjyqësore në Komisariatit e Policisë Shkodër, i cili ka kryer veprimet verifikuese të dokumentuara me shkresat përkatëse. Subjekti i rivlerësimit shprehet se: *“Thelbi i kallëzimit të këtij shtetasi dhe kërkesës së tij ishte pezullimi i procedurës së legalizimit për shtesën pa leje të kryer nga ana e shtetasi F. Y. në pallatin ku jetonin të dy këta persona, fakt që sipas kallëzuesit ishte denoncuar në të gjitha organet ligjzbatuese. Më lejoni të shpjegoj se për sqarimin e faktit në të cilin ngrihej pretendimi, në kuadër të veprimeve verifikuese, pas këqyrjes së vendit janë kryer disa veprime. Është administruar tabela fotografike e këqyrjes së vendit nga ku rezulton e qartë se ndërtimi rezultonte i përfunduar dhe nuk gjendeshin inerte apo materiale të tjera të nevojshme për realizimin e tij, çka tregonte se ndërtimi ishte përfunduar në kohën e paraqitjes së kallëzimit. Rasti kishte specifikën e veçantë pasi i kallëzuari ishte dënuar për veprën penale të ndërtimit të paligjshëm, konkretisht me vendimin gjyqësor nr. ***, datë 15.9.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër”*.

Në vijim, subjekti sqaron se nga hetimi ka rezultuar se lidhur me këtë shtesë nuk ka pasur marrëveshje dhe as dakordësi e bashkëpronarëve të pallatit që të ndërtohej nga i kallëzuari. Për rrjedhojë subjekti ka referuar me informacion drejtuesin e prokurorisë për faktin e hetimit në drejtim të veprimtarisë së ALUIZNI-it që po legalizonte një ndërtim që cenonte interesat e gjithë banorëve të pallatit, pasi për çështje specifike ku përfshihet veprimtaria e zyrtarëve hetimi ndiqet nga njësia e përbashkët hetimore. Por ky fakt nuk është pranuar nga Drejtuesi i Prokurorisë dhe me urdhrin e datës 14.1.2015 është regjistruar procedimi penal në ngarkim të të kallëzuarit për veprën penale “ndërtim i paligjshëm”.

Gjithashtu, subjekti sqaron se: *“Ky procedim penal u pushua për shkak të hyrjes në fuqi të ligjit amnistues për ndërtimet pa leje me nr. ***. Vendimi i është njoftuar kallëzuesit, i cili nuk e ka ankimuar dhe është në fuqi edhe sot. Nga aktet e procedimit penal rezulton se asnjë nga prokurorët më të lartë në strukturën organizative nuk kanë konstatuar paligjshmëri, inkompetencë apo shkelje të të drejtave të njeriut në veprimtarinë time lidhur me trajtimin e kallëzimit të këtij shtetasi”*.

6.1.6 Komisioni, në lidhje me këtë procedim, konstaton se subjekti nuk ka vepruar me efikasitet dhe profesionalizëm e në interesin më të mirë të hetimit dhe nuk ka treguar aftësi për të hetuar e për të marrë urdhëra e vendime në kohën e duhur, si dhe një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e saj, të cilat konsiderohen si mangësi profesionale.

6.2 Praktika nr. *** e regjistruar në bazë të ankesës së shtetasi Gj. Gj.. Ankuesi i është drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm duke kërkuar ndjekje penale ndaj prokurorëve G. Sh. dhe Marsida Frashëri me pretendimin e qëndrimit të njëanshëm prej tyre në hetimin e kallëzimit të tij ndaj punonjësit të policisë A. C.. Materiali është dërguar për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Praktika shkresore rezulton të jetë arkivuar.

Rezulton se shtetasi M. Gj. është deklaruar fajtor për veprën penale të parashikuar nga nenet 278//3, 279/1 dhe 280 të Kodit Penal dhe është dënuar me 2.4 vite heqje lirie, vendim i cili është ankimuar panë Gjykatës së Apelit Shkodër.

6.2.1 Nga kallëzimi i depozituar rezulton se në datën 6.10.2015 (3 muaj pas arrestimit të këtij shtetasi) subjekti ka nxjerrë vendim për zgjatje afati hetimor me qëllim kryerjen e aktekspertimit të lëndës së sekuestruar, pavarësisht se nga subjekti ishte depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë një aktekspertim, ku përcaktohej se lënda e sekuestruar nuk ishte narkotike.

6.2.2 Subjekti i rivlerësimit ka kërkuar zgjatjen e periudhës hetimore edhe 2 muaj të tjerë duke argumentuar se nuk kishte në dispozicion aktekspertimin shtesë. Këtë aktekspertimi shtesë duket se subjekti e ka kërkuar 10 ditë pasi ka marrë vendimin për zgjatje të afatit të hetimeve.

6.2.3 Në përfundim të verifikimeve nga administrimi i dokumentacionit duket se subjekti ka zvarritur hetimet për shtetasin M. Gj., i cili ndonëse i paraburgosur nuk ishte pyetur në cilësinë e të pandehurit.

6.2.4 Komisioni i kaloi barrën e provës subjektivit të rivlerësimit në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 për të provuar dhe shpjeguar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

6.2.5 Në vijim të shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit sqaron se: *“Për sa i përket konstatimit për mosmarrjen në pyetje të shtetasit M. Gj., në cilësinë e të pandehurit, subjekti shpjegon se pyetja e të pandehurit është veprim procedural që pason vendimmarrjen e prokurorit për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës, ndërsa zgjatja e afatit të paraburgimit kushtëzohet nga nevojat e sigurimit dhe domosdoshmëria e zgjatjes kur janë rastet e mbarimit të tij sipas Kodit të Procedurës Penale. Ndonëse në kohën kur është kërkuar zgjatje e afateve të paraburgimit ishin mbledhur të dhëna të mjaftueshme në ngarkim të shtetasit M. Gj., nuk kishte mjaftueshmërisht të dhëna për të konkluduar nëse ai kishte kryer veprën penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”.*

6.2.6 Shpjegimet e subjektivit nuk u konsideruar bindëse për Komisionin duke i konsideruar veprimet e saj me mangësi, në kuadër të vlerësimit profesional.

6.3 Praktika nr. ***, e regjistruar në bazë të ankesës së shtetasit Gj. Gj.. Ankuesi i është drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm duke kërkuar marrjen e masave ndaj prokurorëve G. Sh., Marsida Frashëri dhe Sh. M., për qëndrimin e mbajtur në hetimin dhe gjykimin e djalit të tij M. Gj., i dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe në procedurë gjykimi në Gjykatën e Apelit Shkodër. Prokuroria e Përgjithshme ka njoftuar ankuesin se nuk kishte kompetencë për kontrollin e prokurorëve të rretheve, pas miratimit të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Praktika shkresore rezulton të jetë arkivuar.

6.4 Praktikant nr. *** dhe nr. *** e regjistruar në bazë të ankesës së shtetasit A. K.. Kallëzuesi ka pretenduar se nuk ka asnjë informacion për hetimet e kryera nga prokurorja Marsida Frashëri në lidhje me kallëzimin ndaj institucionit financiar ***. Prokuroria e Përgjithshme ka njoftuar ankuesin se pretendimet në lidhje me procedurat e hetimit ishin objekt i shqyrtimit gjyqësor në gjykatën kompetente. Ndërsa në lidhje me kërkesën e shtetasit L. P. për zëvendësimin e prokurores Marsida Frashëri nga gjykimi i çështjes, është sqaruar ankuesi se nga të dhënat e administruara nuk rezultonin shkaqe ligjore për zëvendësimin e prokurores në gjykimin e çështjes. Praktika shkresore në Prokurorinë e Përgjithshme është arkivuar.

6.4.1 Rezulton se ankuesi ka kallëzuar institucionin financiar *** për falsifikim të firmave të një kontrate të huaj.

6.4.2 Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin datë 11.3.2015, është vendosur mosfillimi i procedimit penal në lidhje me kallëzimin penal nr. ***, viti 2015.

6.4.3 Siç rezulton edhe nga vendimi gjyqësor nr. ***, datë 19.6.2015, subjekti nuk ka kryer veprimet e duhura hetimore, por është mjaftuar vetëm me tërheqjen e kopjeve të akteve të gjyqimit civil, i cili ishte në proces dhe në pyetjen e kallëzuesve L. P. dhe A. K..

6.4.4 Kundër këtij vendimi është ushtruar ankim dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 19.6.2015, ka vendosur të pranojë kërkesën e ankuesit dhe të prishë vendimin e Prokurorisë për mosfillimin e procedimit penal sipas kallëzimit nr. ***, datë 21.1.2015, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, duke urdhëruar Prokurorinë të kryejë hetime të mëtejshme. Kundër këtij vendimi nuk është ushtruar ankim nga Prokuroria.

6.4.5 Në përfundim të verifikimeve nga administrimi i dokumentacionit duket se:

a) Subjekti nuk ka kryer veprimet e duhura dhe të nevojshme hetimore duke vendosur mosfillimin e procedimit penal, pa identifikuar dhe individualizuar faktin që përbën objektin e

veprimtarisë verifikuese, nuk ka konkluduar nëse kontrata ishte e rreme apo e vërtetë, nëse kjo kredi figuronte e disbursuar në favor të huamarrësve dhe nëse kontrata ishte fiktive.

b) Subjekti nuk ka këqyrrur kopjen origjinale të kontratës noteriale, nuk ka pyetur noterin që ka redaktuar kontratën dhe nuk ka këqyrrur kopjen e mandatit bankar që vërteton faktin e disbursimit të kredisë për llogari të institucionit financiar ***.

6.4.6 Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 për të provuar dhe shpjeguar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

6.4.7 Lidhur me konstatimet e Komisionit, subjekti i rivlerësimit shpjegon se çështja e mësipërme është hetuar nga tre prokurorë njëri pas tjetrit dhe subjekti është caktuar me vendimin e datës 6.1.2016: *“Për rrjedhojë, vendimi i mosfillimit të procedimit penal që daton më 11.3.2015 nuk është marrë prej subjektit tim. Regjistrimi i procedimit penal në datën 21.7.2015 për veprën penale ‘falsifikim të dokumenteve’ nuk është urdhëruar prej subjektit tim. Pasi u njoha me aktet e këtij procedimi penal, konstatova se thelbi i kallëzimit penal të shtetasve A. K. dhe L. P. ishte pretendimi se kontrata e huas datë 9.10.2006, e lidhur mes këtyre personave dhe shoqërisë ‘***’, kishte të falsifikuara nënshkrimet e tyre dhe nga ana e prokurorisë ishte marrë një vendim për kryerjen e ekspertimit të nënshkrimeve si te kjo kontratë ashtu edhe te kontrata më e hershme e lidhur ndërmjet shoqërisë dhe huamarrësit, shtetasit M. K., me dorëzanës shtetasen L. P.”.*

6.4.8 Subjekti shpjegon se vërtetësia e lidhjes formale të kontratës përbënte çelësin kyç të zgjidhjes së mëtejshme të çështjes penale dhe organi i prokurorisë detyrohej të hetonte për faktin që krijonte dyshimin se ishte konsumuar vepër penale për pasojat që kishin ardhur. Në këto rrethana, aktekspertimi grafik mbetej i rëndësishëm për shkak të natyrës shkencore të të dhënave që ai ofron. Me administrimin e këtij akti u konkludua se nënshkrimet në kontratë i përkisnin shtetasve A. K. dhe L. P., të cilët kishin paraqitur në prokurori njoftimin e një fakti që ata e dinin se ishte i pavërtetë. Në vijim, këtyre shtetasve iu është komunikuar akuza për kallëzim të rremë. Subjekti shprehet se: *“Çmuj se hetimi në këtë procedim penal ka qenë i plotë dhe gjithëpërfshirës duke zbuluar të vërtetën e kallëzimit, i cili rezultoi të ishte depozituar në prokurori rreth 9 vjet pas datës kur figuronte e lidhur kontrata që pretendohej prej tyre se ishte e falsifikuar dhe palët ishin në konflikt gjyqësor me njëri-tjetrin. Çështja u dërgua në gjykatë me kërkesë për gjykim dhe më duhet të them se nga ana e shtetasve L. P., ditën e njoftimit të akuzës nga oficeri i policisë gjyqësore, është artikulluar verbalisht se po më informonte që punonte sekretare në Gjykatën e Apelit Shkodër dhe duhej të mendoja mirë akuzën ndaj saj”.*

6.4.9 Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato janë bindëse.

6.5 Praktikat nr. *** dhe nr. ***, të regjistruara në bazë të informacionit të dërguar nga Drejtuesit e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për zvarritje të hetimit në disa procedime penale nga prokurorja Marsida Frashëri, janë verifikuar dhe mbajtur në arkiv për t’u dërguar më pas pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

6.6 Praktika nr. *** e regjistruar në bazë të ankesës së shtetasit A. K.. Kallëzuesi ka parashtruar pretendimet e tij në lidhje me vendimin e mosfillimit të prokurores Marsida Frashëri mbi aktet e kallëzimit të depozituar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Materiali është dërguar për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër duke njoftuar edhe ankuesin. Praktika shkresore rezulton të jetë arkivuar.

Ç. VLERËSIMI I DENONCIMEVE

Në Komision kanë ardhur dy denoncime për këtë subjekt rivlerësimi, të analizuar në përputhje me nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, nga Komisioni.

1. Denoncimi i shtetasve A. M., e cila denoncon për dhënie vendimi për mosfillim të procedimit penal në mënyrë të padrejtë. Referuar akteve bashkëlidhur denoncimit rezulton se

në datën 3.12.2016 subjekti i rivlerësimit ka shqyrtuar aktet e kallëzimit penal nr. ***, datë 25.8.2016, të depozituara nga shtetasja A. M. në cilësinë e kallëzueses kundër shtetasit D. M., në cilësinë e të kallëzuarit. Kallëzuesja dhe i kallëzuari janë bashkëpronarë në një pronë, për të cilën figuron se janë lidhur paralelisht kontrata dhënie me qira me persona të tretë.

1.1 Komisioni ka kërkuar informacion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër në lidhje me ecurinë e këtij kallëzimi. Nga shqyrtimi i dokumentacionit¹³ të dërguar rezultoi se:

a) Nga Komisariati i Policisë Shkodër është referuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër materiali procedural, në bazë të kallëzimit të bërë nga shtetasja A. M., i cili është regjistruar pranë kësaj prokurorie më 25.8.2016.

b) Organi i akuzës më 3.12.2016 ka marrë vendimin¹⁴ për mosfillim procedimi penal nr. ***, i cili i është njoftuar kallëzueses me shkresën nr. *** prot., datë 13.1.2017.

c) Ndaj vendimit për mosfillim procedimi është ushtruar ankim prej shtetasës A. M. në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila me vendimin nr. ***, datë 8.6.2017, ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesës ankimore të kërkuësës A. M. duke lënë në fuqi vendimin për mosfillimin e procedimit penal nr. ***, datë 25.8.2016, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër”.

1.2 Nga verifikimi ka rezultuar se kallëzimi i shtetasës A. M. është regjistruar në datën 25.8.2016, ndërsa vendimi për mosfillim procedimi penal është dhënë nga subjekti i rivlerësimit në datën 3.12.2016.

1.3 Në përfundim të verifikimeve nga administrimi i dokumentacionit duket se pas datës 25.8.2016 subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer asnjë veprim hetimor dhe nuk ka zbatuar afatet e përcaktuara në udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, i ndryshuar, duke u shprehur për mosfillimin në tejkalim të afatit 30-ditor.

1.4 Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit shpjegime lidhur me faktet e parashtruara nga denoncuesja.

1.5 Subjekti i rivlerësimit shpjegon se materiali kallëzues i referuar nga Komisariati i Policisë Shkodër nuk specifikonte veprë penale dhe është regjistruar në datën 25.8.2016 gjatë periudhës së lejes vjetore të prokurorëve, rregull që është afirmuar edhe në ligjin nr. 96/2016. Subjekti shprehet se: “Çdo referim i policisë gjyqësore apo njoftim fakti penal nga individë regjistrohej menjëherë në regjistrin e kallëzimeve nga sekretaria por, verifikimi i tyre paraparak dhe caktimi i materialit tek prokurori bëhej nga titullari i prokurorisë, me rinisjen e punës normale në muajin shtator të çdo viti, fakt i cili rezultoi qartë në këtë material kallëzues, i cili është sigluar për ndjekje në emrin tim në datën 1.9.2016, pesë ditë pas ditës së mbërritjes në prokurori të kallëzimit”.

1.6 Në vijim, subjekti sqaron se vendimi i mosfillimit datë 3.10.2016 është marrë brenda 30 ditëve nga çasti i caktimit të materialit kallëzues dhe duke pasur parasysh që afati përfundonte në ditë pushimi javor shtyhet në ditën pasardhëse të punës: “Çmoj se në këtë rast nuk është shkelur afati për mosfillimin e procedimit penal të përcaktuar në udhëzimin nr. 3, datë 19.6.2012, i ndryshuar. Pas marrjes së vendimit, ky i fundit i është nënshtruar kontrollit hierarkik nga zëvendës drejtuesi i Prokurorisë, i cili ka miratuar vendimin pas kontrollit të ligjshmërisë dhe më pas nga kryetari i prokurorisë”.

1.7 Sipas subjektit, vendimi i mosfillimit është i pacenuar, megjithëse është ankimuar prej kallëzueses: “Ai është rezultat i analizës në tërësi të faktit të pretenduar dhe të dhënave të mbledhura në përputhje me rregullat për çmuarjen e provave, parashikuar nga neni 152 i Kodit të Procedurës Penale”.

¹³Shihni shkresën nr. *** prot., datë 26.11.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

¹⁴Referuar neni 291 të Kodit të Procedurës Penale të vitit 2014 germa “a” (të pandryshuar), vendimi për mosfillimin e procedimit jepet: “(a) Kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit”.

1.8 Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato janë bindëse.

2. Denoncimi i Sh. Sh. A., e cila denoncon subjektin e rivlerësimit Marsida Frashëri për korrupsion, shpërdorim detyre dhe shkelje të formave të ndryshme me qëllim përfitimi shumëmonetare prej subjektit të rivlerësimit. Sh. Sh. A. pretendon se subjekti ka bërë shkelje të formave të ndryshme duke renditur disa procedime penale.

2.1 Denoncimi përfshin të dhëna lidhur me procedimet penale: nr. ***, datë 11.9.2014; kallëzimin penal nr. ***, datë 11.11.2014, në vijim regjistruar procedim penal nr. ***, viti 2015; nr. ***, datë 23.8.2016; nr. ***, datë 6.5.2016; procedimi penal në lidhje me kallëzimin penal nr. ***, datë 19.1.2015; procedim penal në lidhje me kallëzimin penal nr. ***, datë 17.3.2015; dhe nr. ***, datë 10.11.2014.

2.2 Komisioni ka kërkuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me shkresën nr. *** prot., datë 4.3.2022, informacion mbi vendimmarrjet e subjektit për procedimet penale të referuara në denoncim, si dhe statusin aktual të tyre. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me shkresën nr. *** prot., datë 16.3.2022, ka dërguar materialin referues.

2.3 Në përfundim, pas analizimit dhe vlerësimit të dokumenteve të administruara gjatë hetimit rezulton se çështjet e referuara në denoncim janë të njëjta me ato të analizuara edhe më herët gjatë kontrollit të pasurisë, përkatësisht çështje të verifikuara nga Grupi i Punës i caktuar nga Prokurori i Përgjithshëm.

2.4 Konkluzionet janë të njëjta si edhe më lart në vendim, ku duket se subjekti ka zvarritur kryerjen e veprimeve hetimore dhe se nuk ushtron me efikasitet detyrën e saj si prokurore.

2.5 Subjekti i rivlerësimit shpjegon se denoncimi i Sh. Sh. A. nuk përfaqëson asnjë fakt apo argument të arsyeshëm që të arrijë nivelin minimal të bazueshmërisë për t'u konsideruar në procesin e rivlerësimit: *“Shkeljet e pretenduara i përkasin një periudhe relativisht të hershme (vitet 2014 - 2015), ndërkohë që denoncimi është adresuar në Komision në nëntor të vitit 2021, në kohën kur tashmë kishte nisur hetimi administrativ nga ana juaj. Duket se avokati në fjalë të ketë qenë në dijeni të zhvillimit të procesit të vettingut ndaj meje. Ky fakt të lë përshtypjen e hidhur se denoncimi nuk është ekzigjencë e parimeve dhe shqetësimeve legjitime të një avokati që do e shqetësonte padrejtësia, por shëmbëllim i interesave meskine për të dëmtuar dhe bërë 'pis' një magjistrate me dinjitet, e cila ndoshta nuk i jep idenë e një zyrtari të drejtësisë me të cilin të mund të bëhen marrëveshje ekstra-ligjore”*.

2.6 Subjekti sqaron se nga kërkimi në Prokurorinë e Rrethit Shkodër ka konstatuar se në vitin 2017 kishte vendosur mosfillimin e procedimit penal për një material kallëzues të inicuar nga një prokuror kundër këtij shtetasi për veprën penale “shpifje”. Subjekti shprehet se: *“Prokurori pretendonte se, gjatë ushtrimit të detyrës së tij, kishte hasur me fyerje e sajesa të këtij avokati në hetimin e çështjeve në të cilat ata ishin subjekte procedimi penal sipas funksioneve që u njihen ligji. Sipas këtij vendimi rezulton se unë, subjekti i rivlerësimit, para pretendimeve të kolegut prokuror, kam mbrojtur lirinë e shprehjes së këtij avokati duke orientuar zgjidhjen e çështjes në gjykatë me të dëmtuar akuzues në përputhje me nenin 59 të Kodit të Procedurës Penale”*.

2.7 Për sa i përket konstatimit të zvarritjes në kryerjen e veprimeve hetimore, për të cilën ka nisur hetim disiplinor nga Prokuroria e Përgjithshme, subjekti i rivlerësimit i ka parashtruar argumentet e saj më lart duke i trajtuar këto raste.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes bazuar në provat e administruara dhe me rezultatet e hetimit, dëgjoji subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara prej saj, konstaton se subjekti ka shfaqur në mënyrë të përsëritur vonesa në trajtimin dhe

përfundimin e çështjeve objekt shqyrtimi, në vazhdimësi gjatë ushtrimit të detyrës së saj si prokurore duke krijuar rrethana që kanë efekt negativ në rezultatet e vlerësimit profesional të saj.

Trupi gjykues i Komisionit, duke vlerësuar në tërësi rezultatet e kontroleve të ushtruara ndër vite dhe shkakun e tyre si dhe vlerësimet e punës, për subjektin, por pa e penalizuar për këto fakte në kuptim të parimit të gjësë së gjykuar, por duke i mbajtur në konsideratë ato, në vlerësim të dina mikës evolutive të performancës së subjektit në periudhën e mëpasme, arrin në përfundimin se prokurorja Marsida Frashëri, në mënyrë të vazhduar pavarësisht tërheqjes së vëmendjes apo marrjes së masës disiplinore, ka vijuar në të njëjtën mënyrë të ushtrimit funksionin me mangësi në aspektin profesional.

Mangësitë e konstatuara janë kryesisht ato të karakterit organizativ dhe veprimt me efikasitet, të cilat kanë sjellë në mënyrë të përsëritur mospërbushjen e detyrës si prokurore, duke konkluduar se nuk është efektive.

Trupi gjykues i Komisionit duke çmuar në tërësi problematikat e konstatuara, duke qenë se këto mangësi rezultuan të vazhduara, ndër vite, por në një normë të pranueshme për të mos sjellë pasojën më radikale të shkarkimit nga detyra në raport edhe me ngarkesën në total të punës së saj dhe çështjet e trajtuara, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e plotësimit të këtyre mangësive nëpërmjet një programi trajnues pranë Shkollës së Magjistraturës.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pas diskutimeve në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të pikës 1 dhe 2, të nenit “Ë”, të Aneksit të Kushtetutës, germës “b”, të pikës 1, të nenit 58, nenit 44/b, si dhe pikës 1, të nenit 60, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Pezullimin nga detyra të znj. Marsida Frashëri, për një periudhë njëvjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës.
2. Në përfundim të këtij trajnimi, pas administrimit të rezultateve të arritura nga subjekti, Komisioni do të përfundojë procesin e rivlerësimit, bazuar mbi të tria kriteret.
3. Ky vendim i njoftohet subjektit të rivlerësimit, vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe Shkollës së Magjistraturës brenda 30 ditëve pas kësaj seance dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Ky vendim është i paankimueshëm, bazuar në pikën 2, të nenit F, të Aneksit të Kushtetutës.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Lulzim HAMITAJ
Kryesues

Valbona SANXHAKTARI
Relatore

Genta TAFA (BUNGO)
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Elda Faruku